**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

**OSHP: 2025/0643**

**OSHP: 2025/0657**

**OSHP: 2025/0660**

**OSHP: 2025/0661**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahimi-Kryesuese, Kimete Gashi-Brajshori dhe Isa Hasani -Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "VIA EGNATIA" SH.P.K., OE "AGRO INVEST 1" SH.P.K., OE "N & B" SH.P.K., si dhe OE "Muhamet Muçiqi", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të "KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS", në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit 616-25-1830-5-1-1, me 16/09/2025, mori:

## Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "VIA EGNATIA" SH.P.K., me nr. 2025/0643, e datës 13/07/2025, ndersa Aprovohen si pjeserisht te bazuara ankesat e OE "AGRO INVEST 1" SH.P.K., me nr. 2025/0657, e datës 17/07/2025, OE "N & B" SH.P.K., me nr. 2025/0660, e datës 17/07/2025, si dhe ankesa e OE "Muhamet Muçiqi", me nr. 2025/0661, e datës 17/07/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

2. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të "KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS", ndërkaq aktiviteti i prokurimit "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit 616-25-1830-5-1-1 kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4.Me qenë se ankesa e operatorve ekonomik ankues aprovohen si pjeserisht, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform

nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

Me 13.03.2025, "KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 780,000.00 €.

Me 01.07.2025 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 per dhënie te kontratës.

Me 04.07.2025, OE "VIA EGNATIA" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58 te Autoritetit Kontraktues. Me datë me datën 05.07.2025, "AGRO INVEST 1" SH.P.K me 07.07.2025 OE "N & B" SH.P.K., si dhe me datën 07.07.2025 OE "Muhamet Muçiqi" kan parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues per dhënie.

Me 07.07.2025 dhe me 08.07.2025 Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilin ka refuzuar si të pa bazuara ankesat e Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues .

Me 13.07.2025, OE "VIA EGNATIA" SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2025/0643 me datë 17.07.2025 OE "AGRO INVEST 1" SH.P.K ankesen me nr.2025/0657 me datën 17.07.2025 "N & B" SH.P.K., ankesën me nr.2025/0660 si dhe ankesa e OE "Muhamet Muçiqi" ankesën me nr. 2025/0661 me datë 17.07.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr te 616-25-1830-5-1-1.

***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0643-0657-0660-0661/2025 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “VIA EGNATIA” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendim 1: AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk kanë luajtur rol aktiv për t’u siguruar se fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive, ekonomike. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Më saktësisht AK pa asnjë të drejtë na ka eliminuar nga konkurrenca edhe pse e ka pa që kemi dorëzuar dëshmi të mjaftueshme që tregojnë se kemi realizuar projekte të ngjashme në të kaluarën. Mos aplikimi si duhet i kërkesave të parapara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit si dhe mos aplikimi i drejt edhe i nenit 59 të LPP-së, e shtynë AK-në jo vetëm drejt shkeljes së nenit 1 të LPP-së por edhe drejt shkeljeve tjera sepse me këtë veprim po tenton që në kundërshtim me realitetin dhe në kundërshtim me nenin 60 të LPP-së, të shpallë fitues një tenderues me çmimin më të lartë se ne. Nga dokumentacionet tona shihet qartë se ne jemi tenderues i përgjegjshëm dhe kemi çmimin më të ulët në krahasim me tenderuesin e shpallur fitues andaj shpërblimi jonë me kontratë është detyrim ligjor që do të ndikonte pozitivisht në shfrytëzim të mjeteve në mënyrë më efikase, më efektive dhe më ekonomike, saktë ashtu siç e kërkon nenin 1 i LPP[1]së. Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet lehtë se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së duke mos vlerësuar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e neneve tjera që do të i potencojmë në vazhdim.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit si të barabartë. Kjo ka ardhur si pasoj e asaj kur AK na ka konsideruar të përgjegjshëm duke na eliminuar nga konkurrenca edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së përkatësisht të dosjes së tenderit që ishin të përcaktuara paraprakisht nga vet AK-ja. Nga arsyetimi për eliminim që na ka dërguar AK dhe pas krahasimit të tij me kërkesat e dosjes së tenderit, shihet se ne jemi tenderues komplet i përgjegjshëm dhe se AK dhe se AK ka pasur mjaftueshëm dëshmi për tu bindur me vlefshmërinë e plotësueshmërisë së kritereve nga ne e veçanërisht për dëshmitë e projekteve të realizuara që ne i kemi paraqitur në tender. Pra AK ka aplikuar ligjin në mënyrë të gabuar kur na ka eliminuar për gjoja mungesë të referencave të Grupit të OE pasi që në kundërshtim të plotë me nenin 59.4 të LPP-së nuk i ka trajtuar dëshmitë si duhet duke mos i marrë fare për bazë ato që kemi dorëzuar. Nisur nga krejt kjo, po shihet hapur se evidentimi kinse i mangësive të dëshmive për realizim të projekteve të ngjashme tek tenderi jonë, konsiderohet diskriminim shumë i madh ndaj tenderit tonë. Shto këtu faktin që ne kemi qenë edhe me çmim më të ulët për afro 20% e cila kur aplikohet në shumën e planifikuar të buxhetit, del që ne kemi tenderin me çmim më të ulët për 156,000.00€ në krahasim me tenderuesin e shpallur fitues. Kjo tregon qartë se AK ka shkelur edhe nenin 1 si dhe 60 të LPP-së duke mos shfrytëzuar aspak mjetet/buxhetin e vet në mënyrë të drejtë dhe ekonomike. Sipas asaj që e thotë neni 7 i LPP-së, kjo konsiderohet trajtim jo i barabartë i tenderuesve përkatësisht favorizim i plotë GOE të shpallur fitues dhe diskriminim i plotë ndaj neve e që njëherit konsiderohet shkelje e pastër e kësaj dispozite ligjore. Më detalisht për secilin gabim të AK-së që ka bërë gjatë këtij procesi të vlerësimit si dhe për çdo mangësi të OE të shpallur fitues, do ju njohim në pretendimet në vazhdim.

Pretendimi 3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të RRPP-001/2022 pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka respektuar kërkesat dhe kriteret e veta nga dosja e tenderit si dhe nuk i ka respektuar as dispozitat ligjore për sqarim të tenderëve duke aplikuar arsye të pa

qëndrueshme me rastin e eliminimit tonë nga konkurrenca. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. E themi këtë sepse ashtu siç e sqaruam edhe tek pretendimi i kaluar shihet se AK na ka eliminuar neve për kritere dhe kërkesa që faktikisht janë plotësuar dhe se të njëjtat edhe është dashur të i të i pranoj si dëshmi të rregullta. 6/10 Arsyeja e eliminimit të tenderit tonë duket kështu: Ky arsyetim nuk qëndron fare sepse ne kemi dorëzuar listën e kontratave nga ku shihet qartë se si Grup i OE në të kaluarën e kemi realizuar kontrata të ngjashme në vlerë të mjaftueshme për ta plotësuar kërkesën e AK-së. Para se të argumentojmë plotësimin e këtij kushti, duam të pasqyrojmë formën se si ishte vendosur kërkesa në dosje të tenderit. Nisur nga forma e kërkesës së parashtruar nga vet AK, dhe krahasuar me listën e kontratave të realizuara nga GOE i jonë në tre vitet e shkuara që e gjeni të bashkëngjitur, shihet se arrihet mjaftueshëm vlera e kërkuar projekteve të realizuara në kontrata të ngjashme. Me që 7/10 vet kërkesa e caktuar nga AK ishte për kontrata të ngjashme, atëherë kjo tregon se është lënë një mundësi e zgjeruar e plotësimit të këtij kriteri edhe me kontrata të ngjashme. Të gjitha kontratat e realizuara nga ne në tre vitet e shkuara mund dhe duhet cilësohen si kontrata të ngjashme dhe se askund në ligj por as tek kërkesa e AK-së nuk është përcaktuar niveli i ngjashmërisë. Vet KRPP ka sqaruar se termi "të ngjashme" ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Pra nuk ka ndonjë specifikë të saktë të aplikim të termit e ngjashme me që as vet AK nuk e ka potencuar se në cilin aspekt dhe deri në cilin nivel do të akceptohet kjo ngjashmëri. KRPP e thotë edhe se si duhet të duket kërkesa e AK-ve për referenca andaj edhe e sqaron se: Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshkruhet si në vijim: "Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara....." Pra askund nuk po përmendet asnjëri nga termet "të njëjta" apo "të ngjashme". Përpos kësaj KRPP e përcakton edhe këtë ku kërkon nga AK-të që çdo herë dhe në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t'i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik siç janë transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi. Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për paranë. Pikërisht në rastin tonë AK nuk ka vendosur si kërkesë decidive se çfarë lloji apo natyre duhet të jenë kontratat e realizuara duke e lënë termin shumë të e hapur si psh. "të ngjashme" të cilin edhe po e keq aplikon duke mos i pranuar si të rregullta dhe si të ngjashme kontratat tona të realizuara në tre vitet e shkuara. Këtë veprim të AK-së e bënë edhe më të pa arsyeshëm dhe më të paligjshëm fakti që as vet KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Nisur nga kjo del qartë se AK ka shkelur edhe nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të RRPP[1]001/2022 në rastin e eliminimit tonë nga tenderi. Përpos kësaj, në këto dispozita dhe dispozitat tjera ligjore shumë qartë e tregohet se çdo herë kur është e mundshme (si në rastin konkret), AK duhet të ketë parasyshë shpenzimin e parasë në mënyrë të drejtë dhe se devijimet e vogla në tender të cilat nuk kuantifikohet dhe nuk përbëjnë

ndryshim të substancës së tenderit, të merren si devijime minore dhe të pranohen si të mirëqena pasi që veprimi i tillë ndikon shumë pozitivisht në shpenzim të parasë publike në mënyrë ekonomike. Nisur nga e tërë kjo dhe pas krahasimit të kontratave tona me punët që do realizohen në projektin në fjalë si dhe duke aplikuar çdo herë konstatimin e KRPP-së për termin "të ngjashme", shihet qartë se ne i kemi plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit për tu cilësuar si të përgjegjshëm dhe me që kemi çmimin më të ulët nga të gjithë tenderuesit e përgjegjshëm, edhe të shpallemi si fitues i tenderit.

Pretendimi 4. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që edhe Grupet e OE-ve që kishin çmimin më të ulët se tenderi jonë janë cilësuar si të papërgjegjshëm nga AK por nuk u janë 8/10 atribuuar të gjitha mangësitë. Pas analizimit të tenderëve të tyre vërehet se gjendja në plotësueshmërinë e kërkesave nga dosja e tenderit nuk është aspak e mirë apo më mirë të themi se vërehen mangësi të mëdha përfshi edhe disa që i ka potencuar vet AK-ja. Ato janë si në vijim: Grupi i OE "Muhamet Muçiqi; HARST Group; SH.P.K.; Valdrini sh.p.k." - Anëtari Eco Clean(Muhamet Muçiqi B.I.) nuk ka ofruar dëshmi te mjaftueshme lidhe me kërkesat e kontratave të ngjashme - Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Ligji ne 05/L-132(vetëm dud); - Ka dorëzuar CV për teknikun që nuk përmban informatat e nevojshme dhe të pa-nënshkruar nga personi që i përket. Grupi i OE "AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Rexha"; - Anëtari Multi Business Group SH.P.K. - Raporti I vlerësimit të riskut e ka por mungon licenca e Kompanisë së licencuar për ushtrimin e aktivitetit të punës profesionale nga siguria dhe shëndeti në punë; - Marrëveshjet mungon emërtimi i pajisjeve tek të gjitha (nuk janë të cekura pajisjet); - Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Ligji ne 05/L-132; - Mungon marrëveshja me NTSH Gjyli Komerc; Grupi i OE "N & B SH.P.K.; BM Group SH.P.K.": - Nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhe me kërkesat e kontratave te ngjashme; - Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Ligji ne 05/L-132(vetëm dud); Përpos kësaj edhe vet GOE i shpallur fitues ka mangësi në tenderin e tyre që e bëjnë atë tender të papërgjegjshëm. Ja si duken mangësitë e tilla: Grupi i OE "BEREQETI - ING; AAB CONSTRUCTION SH.P.K."; - Vlerësuesi i riskut ka licencën por mungojnë Certifikatat sipas kërkesës dhe dëshmisë së kërkuar në dosje të tenderit; - Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Ligji ne 05/L-132(vetëm dud); - Tek pajisja kamion për bartje nuk është ofruar sipas kërkesës se FDT-së pasi që ka ofruar kamionetë me plato bartëse ndërsa ne librezën e prezantuar nga ana juaj shkruan Kamionetë dypellkabinë me dy dyer); - Punëtoret fizik nuk e plotëson kriterin nr. 9 siç është kërkuar (pdf 5.1), mungojnë kontratat e te gjithë stafit fizik sipas listës, për punëtorët Teknik.(lista e paraqitur mungojnë kontratat); Sipas krejt kësaj po shihet se tenderi i Grupit tonë është tenderi që realisht është me çmim më të ulët nga të gjithë tenderët e përgjegjshëm dhe se i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e dosjes së tenderit për tu shpërblyer me kontratë. Pra sipas krejt kësaj po shihet se mos veprimi i AK-së sipas detyrimeve ligjore gjatë procesit të vlerësimit përkatësisht mos sqarimi dhe pranimi si i rregullt i tenderit tonë, e shtynë AK[1]në drejt shkeljes së plotë të nenit 59 të LPP-së.

Pretendimi 5. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk i ka respektuar dispozitat në të cilat thuhet se OE/tenderët duhet që së pari të jenë të përgjegjshëm për nga plotësueshmëria e kërkesave të dosjes së tenderit, e më pas të vlerësohen në renditje sipas çmimit më të ulët. Në rastin tonë AK është dashur të na shpallte neve si fitues sepse i plotësojmë të gjitha kriteret e nevojshme për tu cilësuar si tenderues i përgjegjshëm dhe se posedojmë çmimin më të ulët në krahasim me tenderuesit e përgjegjshëm për së paku 20% apo shprehur në vlera për 156.000.00€. Mos respektimi i këtij kushti nga ana e AK-së e shtynë atë drejt shkeljes së plotë të nenit 60 të LPP-së.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE “VIA EGNATIA” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të RRPP-001/2022, AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së. Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdese ankesën tonë dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marrë: V E N D I M APROVOHET si e bazuar ankesa e Grupi i OE “VIA EGNATIA SH.P.K.; ALL ZONE SH.P.K.; INFRASTRUKTURA SHPK Dega në Kosovë” lidhur me tenderin “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” i iniciuar dhe administruar nga KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINES dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që realisht më pas do duhej që fitues të shpallej Grupi i OE “VIA EGNATIA SH.P.K.; ALL ZONE SH.P.K.; INFRASTRUKTURA SHPK Dega në Kosovë”.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “VIA EGNATIA” SH.P.K., Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eleminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

? Ju si GOE-ik nuk i keni plotësuar kriteret e përcaktuara neNjoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat mbi mundesitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2, për piken e kërkesës nr. 1. Kërkesa: /. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar rne sukses kontrata të ngjashme me vlere minimale prej 780,000.00 6 Euro, në 3 (tri) vilet efundlt (duke fdluar nga data epublikimii te NJoftirnit për kontratë). Deshmia e kërkuar dokumentare: /. Një liste te kontratave të realizuara duke përdorur Aneksin 6 në DT-si, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën, datën e fillimit, datën e përfundimit të kontratës, përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjitën referencat ose pranimet teknike për kryerjen e punëve në lëmin e kërkuar apo të ngjashme, për 3 (tre) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontrate. duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e shërbimeve (Kontrata dhe Referencat duhet te korrespondoj në me njëra tjetrën). Ju si GOE-ik: për kctë pikc të kërkcsës me ofertën e tuaj kcni prezantuar Kontrata dhe rcfercnca (Kontrata dhe Referencat duhet te korrespondojnë me njëra tjetrërif mirëpo kontratat dhe refercncat e dorëzuara nuk kanë të bëjnë me natyrën e punës dhc as me ngjashmërinë e punëve, Kontratat e dorëzuara kanë të bëjne rne natyrën e pastrimit të lumenjve, mirërnbajtjen rrugëve. Sipas UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËShM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK / Lista e kontratave të realizuara e dorczuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se percaktuar/ Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm/ Ncni 69 i LPP-së. Andaj dhe për arsyeje të cekura me lartë jeni rliminuar nga ky Aktivitet i Prokurimit.

Lidhur me pretendimet ankimore (p.l.) të parashtruesit sa i përket arsyeve eleminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si I papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi parimisht nuk i konteston fare arsyet për të cilat është eliminuar oferta e tij si e papërgjegjshme por vetëm thekson që është dashur AK të kërkoj sqarime shtesë. Në rastin konkret nuk ka aspak hapësirë për të kërkuar sqarime shtesë AK në kuptim të nenit 72 të LPP për arsye se kontestuese është natyra e kontratave që është prezantuar nga OE në listën e kontratave. Pra me asnjë sqarim shtesë nuk mund të ndryshohet (dhe as nuk lejohet që të

ndryshohet) natyra e kontratave si të tilla. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore (p.2.) lidhur me tenderuesit e tjerë është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AGRO INVEST 1” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

1.Autoriteti Kontraktues, me datën 13/03/2025/ e kishte shpallur Njoftimin për Kontratë me numrin e prokurimit 616-25-1830-5-1-1, (Numri i brendshëm i prokurimit 616-25-33-5-1-1), me Titullin e Kontratës: “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”.

2.Në këtë Aktivitet të Prokurimit (procedurë të prokurimit) kishin aplikuar (konkuruar) katër Operator Ekonomik, gjegjësisht Grupe të Operatorëve Ekonomik dhe atë:

1)GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K & Rexha SH.P.K & Multi Buisness Group SH.P.K, me çmimin e ofertës prej 79,93 €;

2)DARDANIAA SH.P.K, me çmimin e ofertës prej 430.00 €;

3)GOE VIA EGNATIA SH.P.K & ALL ZONE SH.P.K & INSFRASTRUKTURA SH.PK – Dega në Kosovë, me çmimin e ofertës prej 194.99 €;

4)GOE N&B SH.P.K & BM Group SH.P.K, me çmimin e ofertës prej 167.40 €;

5)GOE Muhamet Muçiqi & HARST Group SH.P.K & Valdrini SH.P.K, me çmim të ofertës prej 69.59 €;

6)GOE BEREQETI – ING & AAB CONSTRUCTION SH.P.K, me çmim të ofertës prej 233.00 €

7)Me datën 30/06/2025/ Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë NJOFTIMIN MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, përmes të cilit e ka shpallur operator Ekonomik të Përgjegjshëm dhe të Suksesshëm GOE BEREQETI – ING & AAB CONSTRUCTION SH.P.K. me çmim prej 233.00€ (Me TVSH);

Ndërsa, ankuesin – GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K & Rexha SH.P.K & Multi Business Group SH.P.K, e kishte eleminuar duke e shpallur të papërgjegjshëm.

8)Kundër Vendimit (Njoftimit) të lartcekur GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K & Rexha SH.P.K & Multi Buisness Group SH.P.K, me datën 05/07/2025/ kishte parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim.

9)Me datën 07/07/2025/ Autoriteti Kontraktues morri VENDIMIN me të cilin e Refuzoi Kërkesën për Rishqyrtim të ankuesit, kundër të cilit vendim ushtrohet kjo ankesë.

Përgjegjshmëria e Parashtruesit të Ankesës - GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K & Rexha SH.P.K & Multi Business Group SH.P.K.

8.Vendimi i ankimuar është marrë si rrjedhojë e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, mos vlerësimit të duhur të provave – dokumenteve nga të cilat vërtetohet plotësimi i kërkesave nga FDT, vlerësimit të gabuar të kërkesave nga FDT, si dhe vendimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 47 dhe 48 të LPPA-së, për shkaqet të cilat do të përshkruhen si në vijim:

I.Pretendimet lidhur me Konstatimin se parashtruesi i Ankesës nuk ka plotësuar kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional nga pika 9.1 & 9.2, rreth dëshmisë se operatori ekonomik ka kryer me sukses kontrata në vlerë prej 780,000.00 Euro, brenda 3 viteve nga njoftimi për Kontratë:

9.Nuk qëndrojnë konstatimet e nxjerra nga AK, se parashtruesi i ankesës nuk ka prezentuar kontrata lidhur me punët e kryera (ngjashme) brenda afatit 3 vjeçar nga njoftimi për kontratë, sepse parashtruesi i ankesës, ka bashkangjitur listën si të kontratave, ashtu edhe të referencave përkatëse lidhur me punët e kryera të cilat janë identike apo të ngjashme me punët nga ky aktivitet i prokurimit, dhe atë:

Kontrata të përfunduara nga lideri- "Agro Invest- 1" Sh.p.k, ndër tjerash edhe këto:

•9.1 Kontratë me titull "Ndertimi strehimores- parkut te qenve me nr. te prokurimit: 616-23-8963-5-2-1, e nënshkruar me datë 03.11.2023 ne mes te AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës dhe GOE "Agro Invest- 1" Sh.p.k & "Bashkimi Meti" Sh.p.k. në vlerë 187'115.00 euro.

Përkitazi me këtë kontratë, është dorëzuar Raporti i punës për Situacionin e VI- të (përfundimtar) i përpiluar me datë 25.11.2024 nga menaxherja e kontratës znj. Zyhrije Pllana.

•9.2 Kontratë me titull "Ndërtimi i sistemit të pompimit për furnizim me ujë në ndërtesat kolektive dhe lagje me nr. prokurimi: 616-22-5780-5-2-1, në vlerë 210'000.00 – Prishtinë, e nënshkruar me datë 12.09.2022 ne mes te AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës dhe OE "Agro Invest- 1" Sh.p.k.

Përkitazi me këtë kontratë, është dorëzuar Referenca për kryerjen e punimeve e përpiluar me datë 11.03.2024 nga menaxheri e kontratës z. Afrim Gashi.

•9.3 Kontratën me titull "Ndërtimi i Parkut Rekreativ – sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës", e cila është kryer më dt.23.12.2022, pra brenda afatit 3 vjeçar nga njoftimi i kontratës, në vlerë totale prej 473,000.00 Euro (Kontratë kjo e kryer nga "Rexha" SH.P.K)

Përkitazi me këtë kontratë, është dorëzuar Raporti i Mbikqyrjes, përpiluar me datë 22.12.2022, nga Organi Mbikqyrës, në përbërje prej Ingj.Dip.Gjeo. Bujar Rama, Inxh.Dip.Ndër. Besim Qelaj dhe Inxh.Dip.Ark Burbuqe Agushi.

•9.4 Kontratën me titull "Ndërtimi i parqeve rekreativo – sportive – Renovimi i Kompeksit Qafa", e cila është kryer me dt.21.10.2022, pra brenda afatit 3 vjeçar nga njoftimi i kontratës, në vlerë prej 570,442.75 Euro (Kontratë kjo e kryer nga "Rexha" SH.P.K)

Përkitazi me këtë kontratë, është dorëzuar Raporti mbi kryerjen e punimeve te parapara i përpiluar me datë 24.05.2021 nga menaxherja, znj. Burbuqe Agushi.

•9.5 Kontratën me titull “Ndërtimi i parqeve rekreativo – sportive në kryeqytet, e cila është kryer në vitin 2022, pra brenda afatit 3 vjeçar nga njoftimi i kontratës, në vlerë totale prej 336,436.16 Euro. (Kontratë kjo e kryer nga “Rexha” SH.P.K

Përkitazi me këtë kontratë, është dorëzuar edhe Letër referenca për kryerjen e punimeve.

•9.6 Kontratën me titull “Implementimi i planit të mobilitetit – sanimi, ristrukturimi i rrugëve, trotuareve me gurë natyral, graniti dhe pllaka kubëza betoni lot III”, e cila është kryer me datë 02.02.2024, pra brenda afatit 3 vjeçar nga njoftimi i kontratës, në vlerë totale prej 494,843.63 Euro (Kontratë e kryer nga “Rexha”SH.P.K).

Përkitazi me këtë kontratë, është dorëzuar Referenca e përpiluar me datë 02.02.2024 e lëshuar nga menaxheri i projektit, z. Ibrahim Gervalla. dhe kontratat e anëtarit tjetër të konzorciumit - “Multi Business Group” Shpk:

•9.7 Kontratë me titull “Rregullimi I trotuareve dhe ndriçimi publik ne fshatin Petrove- faza IV, me nr prokurimi: 617-22-3685-5-2-1, ne vlere 24’777.90 euro.

Përkitazi me këtë kontratë, është dorëzuar Procesverbali i pranimit teknik i përpiluar me datë 13.11.2023 nga komisioni: Shqipe Rexhaj- Kryetare i Komisionit, dhe anëtarët Xhemshir Shabani dhe Hysen Hyseni.

•9.8 Kontratë me titull “Rregullimi I ujesjellesit, kanalizimit dhe infrastruktures tjeter ne fshatin Glloboqice, me nr prokurimi: 621-22-1859-5-2-1 dhe ne vlere 18’454.80 euro.

Përkitazi me këtë kontratë, është dorëzuar edhe Letër referenca për kryerjen e punimeve.

•9.9 Kontratë me titull “Zgjerimi I rruges Regjionale R 107 hyrja ne qytetin e Prizrenit- lot 1, me nr. prokurimi: MI-18-136-511 ne vlere 25’000.80 euro, e nënshkruar me datë 20.09.2022 ne mes të Punëdhënësit – N.P.N. Renelual Tahiri dhe firmës “Multi Business Group” Shpk.

Përkitazi me këtë kontratë, është dorëzuar Letër referenca nga firma N.P.N. “Renelual Tahiri” për kryerjen e punimeve e përpiluar me datë 17.10.2022.

10.Të gjitha kontratat si më sipër, të realizuara nga partnerët e Konzorciumit – GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K & Rexha SH.P.K & Multi Business Group SH.P.K, kanë pasur për objekt kryerjen e punëve të ndërtimit të rrethojave (lëmia e ndërtimtarisë), pra jo që janë të ngjashme, por janë identike me llojin e punëve sipas këtij aktiviteti të prokurimit e që është “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”.

Dhe vlera e punëve të realizuara, e tejkalon shifrën prej 1,905,560.00 (një milionë e nëntëqind e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë), prandaj nga të njëjta mjaftueshëm vërtetohet se parashtruesi i ankesës e ka plotësuar në tërësi Kërkesën mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale nga FDT në pikën 9.1, për të poseduar dëshmi të mjaftueshme se i njëjti ka përfunduar me sukses në 3 vitet e fundit punë në vlerë prej 780,000.00 Euro (shtatëqind e tetëdhjetë mijë), dhe se krejtësisht në mënyrë të gabuar dhe të padrejtë AK ka konstatuar se parashtruesi i ankesës nuk e përmbush këtë kërkesë, kur nga provat vërtetohet krejt e kundërta.

Te gjitha kontratat e realizuara nga GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K & Rexha SH.P.K & Multi Business Group SH.P.K., jane të natyrës së njejtë dhe poashtu kane edhe kod te njejte me

tenderin e aplikuar- 45000000-7, te klasifikuara si Pune ndertimi ne Klasifikimin e Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP), te cilat korrespondojne plotësisht me natyrën e ketij projekti: Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës.

11.Për më tepër, nga Vendimi për Rishqyrtim, rezulton se AK fare nuk i ka vlerësuar dokumentet e bashkangjitura, ku nuk e përmend fare në Vendim asnjërën prej dokumenteve të bashkangjitura (asnjërën prej kontratave të bashkangjitura nga parashtruesi i ankesës, asnjërën prej raporteve të kryerjes së punëve, asnjërën prej referencave . Në kuptim të nenit 48 par.1 të LPPA-së, Vendimi është dashur që të ketë arsyetim të mirëfilltë dhe të sqaroj vlerësimin e secilit prej dokumenteve të kërkuara dhe se pse AK e ka vlerësuar se dokumentet nuk e plotësojnë këtë kriter, dhe atë specifikisht për secilin veç e veç.

Nuk mundet AK, që vetëm të konstatoj se nga dokumentet e bashkangjitura nuk vërtetohet se ka kryer punime, por duhet që të vlerësoj secilin dokument dhe për secilin prej tij, gjë të cilën nuk e ka bërë AK, për çka vendimi është i paligjshëm dhe i padrejtë.

AK ka qenë në dijeni, se parashtruesi i ankesës, e ka përmbushur në tërësi këtë kriter nga dokumentet e dorëzuara, prandaj duke ditur se po sjellë një vendim të paligjshëm, vetëm në mënyrë të përgjithësuar ka konstatuar mos plotësimin e kësaj kërkese, por duke e mos e marrë në konsideratë – vlerësim asnjërën prej dokumenteve dhe duke mos e thënë asnjë fjalë të vetme për asnjërin prej tyre.

Sipas nenit 48 par.1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimi sipas Kërkesës për Rishqyrtim është dashur që në mënyrë konkrete, të specifikoj vlerësimin e secilit prej dokumenteve, të konstatoj – jap arsye se si është vlerësuar i njëjti dhe për secilin veç e veç të sqaroj se pse është konsideruar se nuk e kanë plotësuar këtë kriter.

II.Pretendimet lidhur me Konstatimin se parashtruesi i Ankesës nuk ka plotësuar kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional nga pika 9.1 & 9.2, rreth dëshmisë se opratori ekonomik nuk posedon marreveshjet me stafin profesional dhe teknik siç duhet:

12.Pretendimi I Autoritetit se marrëveshjet e dorëzuara për stafin profesional dhe teknik nuk përmbajnë elementet e nevojshme të një parakontrate pune, si dhe se mungon një aneks shtesë në përputhje me Ligjin nr. 03/L-212 për Marrëdhëniet e Punës, ju argumentojme se një pretendim i tillë është krejtësisht i pabazuar, i padrejtë dhe në kundërshtim të plotë me ligjin per prokurim publik perkatesisht me nenin 48 par.1 të LPPA-së.

Konform kesaj kerkese, grupi I konzorciumit ka paraqiturne Listen e stafit profesional dhe atij teknik se bashku me Marreveshjet te cilat përmbajnë të gjitha elementet thelbësore të përcaktuara me ligj për të cilësuar një marrëdhënie të vlefshme pune duke përfshirë:

•Emrin e projektit per te cilin behet bashkepunimi;

•Datën e lidhjes së marrëveshjes;

•Të dhënat e plota të stafit (emër, mbiemër, pozicioni, detyra);

• Perpilimi ne dy kopje dhe validiteti I marreveshjes per asistim deri ne perfundimin e plote te projektit nga kompania jone;

• Nenshkrimi dhe vula e kompanise tone dhe stafit qe do te angazhohet ne kete tender.

Pretendimi I Autoritetit Kontraktues mbi mungesën e një “aneksi” nuk mbështetet në asnjë dispozitë të Ligjit nr. 03/L-212. Ky ligj nuk parashikon askund ndonjë obligim ligjor për përfshirjen e një aneksi shtesë për vlefshmërinë e një parakontrate pune per bashkëpunim dhe nuk eshte kerkuar as ne dosje te ketjj tenderi.

Ky arsyetim është skandaloz, arbitrar, i paligjshëm, diskriminues dhe është favorizues për palë të treta (fituesin e shpallur), është keqdashës dhe me vullnet të plotë shkelet ligji nga AK, duke mos u zbatuar Ligjshmëria, Trajtimi i Barabartë, e Vërteta Objektive, ngase askund në Dosjen e Tenderit nuk kërkohet që me rastin e plotësimit të kësaj kërkese, OE duhet që të posedoj në ndonjë formë të caktuar këtë kriter, pra nuk kërkohet në FDT të Dosjes së Tenderit se dëshmitë lidhur me posedimin e kapaciteteve njerëzore (kapaciteteve teknike dhe profesionale) të dorëzohen në ndonjë formë të caktuar. Që do të thotë, mjafton në cilëndo formë të caktuar përmes të cilave është shprehur vullneti për tu angazhuar si punëmarrës në këtë aktivitet të prokuimit, për tu konsideuar ky kriter i plotësuar dhe në asnjë mënyrë mos të kërkohet që AK të kërkoj një formë të caktuar të parashtrimit të dokumentacionit, për dallim nga mënyra siç parashihet në Dosjen e Tenderit.

Nga marrëveshjet e dorëzuara, në secilën prej tyre, saktë konstatohet se të njëjtat janë lidhur ekskluzivisht për këtë aktivitet të prokurimit – “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”, dhe se nga këto marrëveshje nuk vihet në asnjë dilemë qëllimi se për çfarë janë lidhur të njëjtat.

AK ka shpërfillur Dosjen e Tenderit dhe ka bërë interpretime jashta kërkesave të përcaktuara me të.

Për më tepër, nëse Marrëveshjet e dorëzuara kanë pasur ndonjë mangësi, AK e ka pasur për obligim që ne si tenderues, të na kërkoj plotësim/korigjimet e nevojshme, e jo të konstatoj mungesë të dokumentacionit kur i njëjti veçse është dorëzuar, e ku dorëzimin dhe prezenzën e tij e konstaton vetëm AK me rastin e rishqyrtimit.

Edhe njëherë përmes kësaj ankese, i ridorëzojmë marrëveshjet nga të cilat vërtetohet plotësimi i plotë i kërkesave për stafin, dhe atë stafin profesional:

1.Marreveshje bashkepunimi me Inxhinierin konstruktiv, z. Blond Mecinaj.

2.Marreveshje bashkepunimi me Inxhinierin e makinerisë, z. Isa Bajraktari.

3.Marreveshje bashkepunimi me gjeodetin, z. Agron Shabani.

Marrëveshjet me stafin teknik të çertifikuar:

1.Marreveshje bashkepunimi me z. Valon Elshani- Teknik i ndërtimtarisë.

2.Marreveshje bashkepunimi me z. Besfort Bajraktari- Teknik i makinerisë.

3.Marreveshje bashkepunimi me z. Ramadan Muharremi- saldues.

4.Marreveshje bashkepunimi me z. Ramadan Muharremi- saldues.

5.Marreveshje bashkepunimi me z. Ramadan Muharremi- saldues.

6.Marreveshje bashkepunimi me z. Ramadan Muharremi- saldues.

dhe marrëveshjet me stafin teknik- gjithsejt 12 punëtorë.

Papërgjegjshmëria e GOE te shpallur fitues- BEREQETI ING SH.P.K & AAB CONSTRUCTION SH.P.K

Nese AutoritetI Kontraktues, me "kontrata të ngjashme" iu ka referuar Kontratave qe kane te bejne me ndertimin dhe rregullimin e rrethojave (kontrata te pranuara nga ju ne oferten tone), atehere del se GEO te shpallur fitues ka paraqitur keto kontrata te ngjashme:

Kontratat dhe referencat e perfunduara nga Lideri- BEREQETI- ING SHPK:

1)Rregullimi I rrethojes se oborrit ambulances se mjekesise familjare ne fshatin Sllatine e Madhe ne vlere 40'818.40 euro

2)Rregullimi I fushave te sportit , nderrimi I barit sintetik dhe riparimi I rrethojave ne SHFMU Mihail Grameno dhe SHFMU Selman Riza ne Fushe Kosove. Kema Company ne vlere 20'409.20 euro.

3)Rikonstruimi dhe mbyllja e vendeve te hapura te rrethojes pergjate "Nena Tereze" ne vlere 6'921.50 euro.

4)Rregullimi dhe rrethimi I varrezave ne Komunen e Drenasit ne vlere 49'612.50 euro.

Ndersa Kontrata e perfunduar nga  firma AAB Construction Sh.p.k

1)Ndertimi I varrezave ne fshatin Krushe e vogel- Vazhdimi I projektit- Projekt dy vjeqar numri I prokurimit 622-24-2408-5-2-1 ka vleren 88'630.00 euro.

Totali I ketyre kontratave per pune qe kane te bejne me ndertimin dhe rregullimin e rrethojave, te paraqitura nga GEO ne fjale, ka  vleren 206'391.6 euro. Konsiderojme se ata nuk e plotesojne kerkesen per kontrata dhe referenca ne vlere prej 780,000.00 € euro.

Tek kerkesat per Listen e makinerise, te domosdoshme per kete tender; Kerkesa 10. Operatori ekonomik duhet ti ketë pajisjet e nevojshme të cilat janë të obligueshme për realizimin e punimeve si ne Aneksin 8 të DT-së, nder tjerash kerkohen:

Pika 10. Kamionete per bartjen e mbeturinave dhe

Pika 12. Paisje perzirse e betonit per eskavator.

Per piken 10. Kamionete per bartjen e mbeturinave GOE ka paraqitur Librezen per mjetin me pershkrimin  "Kamionete dubelkabine me 3 dyer" e tipit Volkswagen VW me peshe totale 2650 kg dhe ne pronesi OE AAB CONSTRUCTION SHPK.. Siç shihet ne librezen e paraqitur nga ta, nuk shkruan Kamionete per bartjen e mbeturinave dhe si e tille ky mjet nuk e ploteson kushtin e kerkuar por eshte mjet per bartjen e punetoreve. Kjo verehet shume lehte edhe ne foton e ofruar per kete mjet.

Ndersa per piken 12. Paisje perzirse e betonit per eskavator, GOE nuk ka paraqitur fare asnje dokument qe deshmon per posedimin e saj.

Poashtu Grupi i operatorëve ekonomik BEREQETI ING SH.P.K & AAB CONSTRUCTION SH.P.K., ka bere shkelje te rende te normave dhe ligjit per prokurim publik pasi qe ne ofertimin e tyre ka paraqitur te falsifikuar dokumentin “Kontrate mbi dhenjen ne shfrytezim te mekanizmit te punes”.

Në kuader te Aneksit 8 të dosjes së tenderit ne piken 8, kërkohet një Kamion Kipper me Kran me peshë bartëse deri në 3 ton. Kompania jonë ka ofruar marrëveshjen e bashkëpunimit, të nënshkruar dhe vulosur me kompaninë SEFERI GROUP SH.P.K, si dhe librezën përkatëse të mjetit te kesaj firme, me ç’rast jemi dakorduar per marrjen e tij me qera ne rast te fitimit te tenderit.

Ndërkohë, është e qartë dhe e dokumentuar se kompania AAB CONSTRUCTION SH.P.K, , ka përdorur të njëjtën librezë mjeti, në mënyrë të njeanshme, pa miratim dhe pa marrëveshje reale me firmen SEFERI GROUP SH.P.K.

Marreveshja e paraqitur nga ky operator është një falsifikim i pastër, me vulë dhe nënshkrim të falsifikuar, të cilat krahasuar me dokumentet tona origjinale janë lehtësisht të identifikueshme si të rreme.

Në këto kushte, ne ngrisim dyshime të forta se ka një marrëveshje të paligjshme dhe të qëllimshme mes autoritetit kontrakues- Kuvendi I Komunes se Prishtines dhe grupit të operatorëve BEREQETI ING SH.P.K & AAB CONSTRUCTION SH.P.K.

Per keto arsyje GOE te emeruar per kontrate eshte dashur te shpallet si ofertues i papergjegjshem dhe te eleminohet nga ky aktivitet i prokurimit per shkak qe i mungojne makinerite e kerkuar ne dosje te ketij tenderi.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi “AGRO INVEST 1” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, Ligjin Nr. 05/L-092 të (LPP), janë: Neni 1 - Qëllimi Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar) Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion UDHËZUES Nr. 002/2024, për Plotësim Ndryshimin e Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik Paragrafi: 9.2 i Neni 9. Kriteret e dhënies së kontratës Paragrafi: 10.1 i Nenit 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve. Shkeljet e dispozitave - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik –(RRUOPP A01), janë: Neni 28- Kriteret e Dhënies së Kontratës Neni 41- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 39 - Sqarimi i Tenderëve. Prandaj, Kërkojmë nga OSHP-ja që lidhur me vlerësimin e kësaj Ankese të mban seancë publike, dhe Ankuesen ta njofton përpara seancës (në afatin ligjorë) në mënyrë që e njëjta së bashku me Avokatët e saj të marrë pjesë në seancë pranë Panelit Shqyrtues të OSHP-së. Nga arsyet e cekura me larte i propozojmë Panelit Shqyrtues të OSHP-së që të sjellë këtë: V E N D I M te APROVOHET si e bazuar ankesa e GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K & Rexha SH.P.K & Multi Business Group SH.P.K ANULOHEN SI TË PALIGJSHËM Njoftim – Vendimi i Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës nr.prokurimi 616-25-1830-5-11, me titull “Ndërtimi i Rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës, i datës 30.06.2025, si dhe Vendimi i

Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës, i datës 07.07.2025, me të cilin është Refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE “Agro Invest 1”SH.P.K . (me të njëjtin numër të prokurimit të cekur si më lartë), dhe lënda kthehet në Rishqyrtim dhe Rivendosje te Autoriteti Kontraktues (në bazë të dispozitave ligjore), duke shpallur fitues GOE “AGRO INVEST 1’ SH.P.K & ‘Rexha” SH.P.K & “Multi Business Group” SH.P.K si oferte e suksesshme dhe me çmim më të lirë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “AGRO INVEST 1” SH.P.K Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eleminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

? Ju si GOE-ik nuk i keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkcsat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2, për piken e kërkesës nr.l. Kërkesa: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme me vlere minimale prej 780,000.00 € Euro, në 3 (tri) vitet efundit (duke filluar nga data epuhlikimit teNjoftimitpër kontratë). Dëshmia e kërkuar dokurnentarc: 1. Një liste te kontralave të realizuara duke përdorur Aneksin 6 në DT-së, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën, datën e fillimit, dalën e përfundimit lë kontratës, përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjilën referencat ose pranimet teknike për kryerjen e punëve në lëmin e kërkuar apo të ngjashme, për 3 (tre) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e shërbimeve (Kontrata dhe Referencat duhet te korrespondojnë me njëra tjetrën). Ju si GOE-ik: për këtë pikë të kërkesës me ofertën e tuaj keni prezantuar Kontrata dhe referenca mc vlerë vetëm 187,000.00 euro të cilat I përgjigjën kërkesës se AK-së për punë të ngjashme (Kontrata dhe Referencat duhet te korrespondojnë me njëra tjetrëri), ndërsa kontratat dhe referencat tjera të dorëzuara nuk kanë të bëjnë me natyrën e punës dhe as me ngjashmërinë e punëve. Dhe Sipas UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMTN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK / Lista e kontratavc të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimalc të vlerësse pcrcaktuar/ Refuzo tcnderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm/ Ncni 69 i LPP-së.

Ju si GOE-ik për të gjithë stafin profesional dhe teknik keni paraqitur marrëveshje bashkëpunimi, ku në ncnin 1 te kësaj marrëveshje shkruhet: “Kjo marrëveshje ndërmjet palëve me datë 11/04/2025 për bashkëpunim behet me qellim të asistimit për realizim tëprojektit". Marrëveshjet c dorëzuara për stafin profesional dhe teknik nuk përmbajnë të gjitha pikat të cilat duhet të ketë një kontrate apo marrëveshje për punë. GOE-ik cdhe pse ka dorëzuar ketë marrëveshje nuk e ka të cekur askund që në rast të shpërblimit me kontratë do të bëjnë nje ancks marrëvcshje ku në bazë të LIGJINR. 03/L-212 I PUNËS do të jenë të përcaktuara: Vlefshmëria e kontratës, orari dhe vcndi i punës, kompensimi i pagës, pushimi vjetor dhe injckësor, ndërprerja c kontratës etj. Andaj dhe për arsyeje të cekura me lartë jeni eliminuar nga ky Aktivilet i Prokurimit.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eleminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si I papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi lista e kontratave të prezantuara që janë realizuar në tre vitet e fundit para njoftimit për kontratë dhe që janë kontrata të ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit, nuk arrijnë vlerën e kërkuar sipas DT. Komisioni ka gjetur se janë prezantuar edhe kontrata të tjera mirëpo të cilat nuk janë të natyrës së ngjashme.

Per faktin se GOE tek përshkrinii i cmimeve ne paramas dhe parallogarit ka dhene cmime shume te larta mbi tregu aktual, qe do te thote se AK - Komisioni i vlerësimit nuk ka hulumtuar dhe analizuar fare çmimet e tregut si dhe nuk ka luajtuar rol aktive fare, por edhe perkundcr qe nuk ika plotesuar Kriteret e përzgjedhjes te cituar si me lart nga ana jone ne kete KpR, ka prilur plot 73 dite per te rckomanduar per Kontrate nje GOE i cili ka tenderuar me cmimet shume te larta dhe demtohet ne mas te madhe Buxheti i komunes dhe kjo nuk ju lene përshtypje fare AK - Komisionit te vlerësimit, ketu dyshojm se ne etiken dhe profesionalizimin e AK - Komisionit te vlerësimit, i cili fare nuk eshte marr me kete pjese dukc shkelur nenin 4 te Rregullorese pasi qe

pas qasje nen dokumcnte te tendeirit per kete AP askënd nuk na eshte prezantuar sqarime per cmime te larta si dhe hulumtimi apo/ose analizimi i tregut duke marr per baze kontrata e me pareshme dhe cmimet real te tregut per kete natyre te AP, qe do te thote sc GOE ne asnjë menyre nuk guxon te rekomandohet per kontrate pasi qe ka cimime ekstrem te larta ne te gjitha pozicionet tekpershkrimi i çmimit ne paramas dhe parallogarit.

Prove: Procesverbcili i hapjes, Pershkrimet e cmimeve dhe cmimet e tregu ( nese AK nuk APROVON KpR ne do nibledhim prova nga treguper dëshmuar para institucioneve tjera per cmime ekstrem te larta).

PRETENDIMET ANKIMORE LIDHUR ME ELEMNIMIN E OPERATORVE EKONOMIK PJESEMARRES NE KETE AKTIVITET T EPROKURMIT si ne vijim:

1.Lidhur e elemnimin c GOE - Agro Invest 1 SHPK ; Rexha; Multi Busincss Group Shpk - Suhareke , ne pajtohemi me elemnimin nga AK lidhur me mungesen e referencave dhe kontratave si dhe marrëveshjet e bashkpunimit per stafm teknik dhe profsioan nuk janc ne pajtim me ligjin e punes, andaj me te drejt eshte elaminuar...

2.Lidhur e elemnimin e OE - Dardania Shpk - Prishtine , nc pajtohemi me elemnimin nga AK lidhur me mungesen dokumentacionit perveq formulairt te tenderit, cmimcve dhe kërkesat e pranushmerise, andaj me te drejt eshte eleminuar nga ky AP.

3.Lidhur e elemnimin e GOE - VIA Egnatia ; All - ZONE: Infrastruktura Shpk - Prishtine, ne pajtohemi me elemnimin nga AK lidhur me mungesen e referencave dhe kontratave, Po ashtu i mungon edhe perzires e betonit qe montohet ne eskavator ; mungon tekniku i makinerise; mungon specalisti i saldimeve. andaj me te drejt eshte eleminuar nga ky AP.

4.Lidhur e elemnimin e GOE - N & B Shpk: BM GROUP SHPK — Skenderaj , ne pajtohcmi me elemnimin nga AK lidhur me mungescn e stafit teknik dhe profesional dhe certifikatave dhe iso Standardeve te kërkuar ne DT dhe NJK , po ashtu i mungon edhekamionkuper me kran pas ika skaduar afati i regjistrimit 11 dite para dorëzimit te tenderit; mungon edhe perzires e betonit qe montohet ne eskavator,mungon kamionet per bartjen e mbeturinave, nuk ka prezantuar kontrata ten atyre se ngjashme per kete AP, andaj me te drejt eshte eleminuar nga ky AP.

Gjithashtu, ne perveq qe kemi tenderuar ne pajtim te plote me te gjitha kriteret e përzgjedhjes tc përcaktuar ne dosje tenderit, po ashtu duke plotesuar kërkesat teknik dhe/ose profesionale te percaktuar ne nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se, po ashtu NE kemi tenderuar edhe me çmimin mcm te ulet te pergjegjshem duke vendosur çmimin me te ulete se sa GOE te rekomanduar per kontrat per rreth: 194% me shtrenjte se sa ofcrta jone..

Me kete veprim AK - ZPP ka shkelur parimin keryer te prokurimit “VLEREN PER PARA” me rastin e eliminimit tone dhe rekomandimin e GOE per dhenie te kontrate, duke demtur Buxhetin e Komunes dhe te Republikes se kosove ne vlcre: 233.00 Euro , pasi qe ka rekomanduar nje GOE te papergjeshem si dhe ne ka eleminuar NE si GOE me cmiminmete ulet te pergjegjshem nee vlere: 79.93 Euro . Pervcq kësaj AK nuk merret me çmimet e GOE te rekomanduar per kontrate te cilat jan mbi çmimin e tregut dhe qe shume lejte mund te vërtetohet nga kontrata e nënshkrua me pare per kete AP dhe cmimet e tregut.

Provë: Pershkrimi i Cmimeve te dorezuar nga ana jone - Procesverbuli i hapjes, Kontrarat e tienshkruar nga AK - Komuna e Prishtines per natyren e njëjte te prokurimit - cmimet e tregnt

real. Ne mbesim me shpresen se AK - ZPP do te reflektojn dhe te shterrin te gjtiha mundesit ligjore te cilat jane te parapar nie dispozita ligjore te LPP-se, dhe te signrohen dhe tc konstatojn sc NE si GOE jemi te pergjegjschin dhe plotesojm knshtet dhe kriteret e dhenies sipas dosjese se tenderit dhe njoftimit per kontrate. Nese nuk merren per baze ne detyrohemi pa vullnetin tone ti drejotohemi institucioev tjera relevante.

VEMENDJE - Sqarime per ESH:

Lusim ESH te analizj arsytimin e elemnimit ton nga AK si dhc nga ana jone si prtcndime i pare dhe vendimtare per kete AP, pasi qe ka mjaft fakte dhe prova si dhc VENDIME tc OSHP-se, qe kane zgjidhur rastin tone dhe te deshmoj me fakte dhe prova konkrte dhe logjike e profesionale!... ne respektimin e dispozitave ligjore te LPP-se!

Po ashtu AK - ZPP nuk ka shqyrtuar dhe nuk eshte pergjigjiur ne KpR te cilen kemi ngritur pretemindemt tona ankiniore pran AK - dhe me kete veprim AK - ZPP nuk ka respektuar NENIN 108/A te LPP-se, dhe dispozitat e nenit 7, 59 dhe 60 tc LPP-se. Per faktin se nuk ka arsytuar ne asnje rrethan dhe menyre elemnimin tonc por eshtc arsytuar pa fakte dhe pa arsyshemeri dhc Logjikc tc Ligjcve dlic dipozitave te LPP-se.

Prove: Bashkangjesimin Deklarat nga tekniku z. Agron Bytyqi ku AK- ZPP dhe Komisoni i vleresimit kane qene te obliguar tc veprojn ne pajtim me nenin 52.7 te LPP - sepse elemnimi yn eska logjoki dhe as baze ligjore ne LPP.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me neiiin 59 LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edh kriteri kryesore për dhënie te kontratës, e qe ka qenc tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet, sipas ncnit 60 paragrafil.l i LPP-së.

Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar ketë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe nenin 1 te LPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimcve te tjera te autoritetcve kontraktues ne Kosoves.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, "Muhamet Muçiqi" konsideron se Autoriteti Kontraktues KUVENDI1 KOMUNESSE PRISHTINES-shkelur këto Dispozita Ligjore të LPP-së, si në vijim: Neni 1 të LPP-së, Ncni 2 të LPP-së, Neni 6 të LPP-së, Neni 7 të LPP-së, Neni 24 te LPP-së, Neni 52 par. 7 të LPP-së. Neni 56 të LPP—së. Neni 55 i LPP-së, Neni 59 par. 1, 2 dhe 4 të LPP-së, Neni 60 par. 1.1 te LPP-së. Ncni 72 i LPP-së, Neni 40.3 40.6; 40.7 dhc 40.8 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP, Nenin 45.22 tc Rreg. Nr. 001/2022 per PP, Nenin 45.26 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP, Ncni 4 i Udhëzuesit Nr. 002/2023 për PP. Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe dëshmitë qe u ceken me larte, kërkojmë nga AK-ja - ZPP qe te merr: V E N D I M te APROVOHET, - si te bazuar Kerkesen per Rishqyrtim nga GOE: Muhamet Mnçiqi; HARST Gronp SH.P.K.; Valdrini sh.p.k, LLAPASHTICË E EPËRME, 11000,, Kosovë ANULOHET, - njoftimi mbi vendimin e AK-se për dhenie te kontrates dhe lënda te kthehet ne RIVLERESIM, - Autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave te bëhet ne

harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave te LPP- së.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “Muhamet Muçiqi” Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eleminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Ju si GOE-ik nuk i keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkcsat mbi mundësitë teknikc dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2, për pikcn e kërkesës nr. 6. Kërkesa: Një (1) ieknik të makinerisë, i trajnuar për siguri dhe shëndet nepune dhe mbrojtje nga zjarri. Dëshmia e kërkuar dokumentarc: 6,’Diplomën (kopje); ’Certifikatat; ’Biogrqfia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; ’Kontratën e pttnës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët;. Ju si GOE- ik: për këtë pikc të kërkcsës mc ofcrtën tuaj kcni prczantuar tcknik të Makincrisc z. Ason Bytyqi dhe kcni dorëzuar dokunientacionin: Diplomën, Ccrtifikatat, Kontratë për kryerje të shërbimcve si dhe Biografinë CV-në - CV e dorëzuar nuk përmban informatat c kërkuara, andaj sipas LIDHËZIJES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUF.SIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK/CV- ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat/ Refuzo tcndcrin pa kërkuar informacion të mëtejshëm/ Neni 69. Ju si GOE-ik keni prezantuar - dorëzuar CV-në e pa nënshkruar nga kandidati z. Agon Bytyqi.. Andaj dhe për arsyeje të cekura me lartë jeni eliminuar nga ky Aktivitel i Prokurimit.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eleminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si I papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi parimisht nuk i konteston fare arsyet për të cilat është eliminuar oferta e tij si e papërgjegjshme por vetëm thekson që është dashur AK të kërkoj sqarime shtesë. Në rastin konkret nuk ka aspak hapësirë për të kërkuar sqarime shtesë AK në kuptim të nenit 72 të LPP për arsye se sipas pikës 10 të UPP përcaktohet që në rastet kur CV nuk i përmbush kërkesat e DT – tenderi refuzohet pa kërkuar sqarime shtesë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesit e tjerë është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001 / 2022 për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi shyrtues i prokurimit me datë 15.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesave me nr. 0643/2025, me datën 17.07.2025 ka autorizuar ekspertin per ankesën me nr.0657/2025 si dhe me datën 17.07.2025 ka autorizuar ekspertin per shyrtimin e pretendimeve ankimore per ankesën 0660/2025 si dhe me datën 17.07.2025 ankesen me nr.2025/0661.

Lidhur me ankesën nr. 0643/2025 me datë 29.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2025/0643 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 0657/2025 me datë 29.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me Nr. 2025/0657 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 0660/2025 me datë 29.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me Nr. 2025/0660 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 0661/2025 me datë 29.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me Nr. 2025/0661 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës me nr.0643/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk ka dhen përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertes shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet rreth raportit te ekspertes shqyrtuese.

Raportin e ekspertizës me nr.0657/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhen përgjigje dhe OE pajtohet.

Raportin e ekspertizës me nr.0660/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhen pergjigje , ndërsa OE nuk ka dhen përgjigje me raportin e ekspertes shqyrtuese.

Raportin e ekspertizës me nr.0661/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhen pergjigje , ndërsa OE pajtohet rreth raportit te ekspertit shqyrtuese.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertes shqyrtuese, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "VIA EGNATIA" SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0643 ka vlerësuar si në vijim:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Ankesa me numër 2025/0643 është parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomikë "VIA EGNATIA SH.P.K.; ALL ZONE SH.P.K.; INFRASTRUKTURA SH.P.K. – Dega në Kosovë" kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit për "Ndërtimin e rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës". Sipas ankuesit, eliminimi i tyre nga gara është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores për Prokurim Publik, përkundër faktit se ata kanë ofertuar me çmimin më të ulët dhe kanë dorëzuar dëshmitë për përvojë të mjaftueshme. Në ankesë pretendohet se AK ka dështuar të vlerësojë ofertën e tyre në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, duke mos marrë parasysh kontratat e realizuara nga grupi për punë të ngjashme. Gjithashtu, theksohet se janë aplikuar standarde të dyfishta në vlerësimin e OE-ve tjerë, përfshirë edhe atë të shpallur fitues, i cili sipas tyre ka pasur mangësi të dukshme në dokumentacion. Ankuesi konsideron se është shkelur parimi i barazisë, i transparencës dhe i ekonomizimit të fondeve publike, dhe kërkon anulimin e vendimit të AK-së si dhe kthimin e lëndës në rivlerësim.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të paraqitura nga grupi i Operatorëve Ekonomikë "VIA EGNATIA SH.P.K.; ALL ZONE SH.P.K.; INFRASTRUKTURA SHPK – Dega në Kosovë" kundër Autoritetit Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës". Pas shqyrtimit të ankesës me nr. 2025/0643, si dhe dokumentacionit të publikuar në platformën e prokurimit elektronik, eksperti shqyrtues paraqet analizën dhe vlerësimet në vijim:

Pretendimi Ankimor Nr. 1:

Operatori Ekonomik ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke mos siguruar administrim efikas, efektiv dhe ekonomik të procedurës së prokurimit. Sipas ankuesit, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, AK ka dështuar të respektojë në mënyrë të drejtë dhe objektive kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Konkretisht, ankuesi thekson se është eliminuar pa të drejtë nga gara, pavarësisht se ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për përvojë të mëparshme në projekte të ngjashme. Mosrespektimi i kritereve të tenderit dhe zbatimi jo i drejtë i nenit 59 të LPP-së ka çuar, sipas tyre, në shpalljen si fitues të një operatori tjetër me çmim më të lartë, në kundërshtim edhe me nenin 60 të LPP-së. Ankuesi vlerëson se oferta e tyre është e përgjegjshme dhe përmban çmimin më të ulët, andaj shpërblimi i saj me kontratë do të siguronte përdorim më të mirë të fondeve publike, në përputhje me parimet e nenit 1 të LPP-së. Sipas tij nga vlerësimi i ofertave, rezulton që çmimi i ofertës së tij është rreth 156,000 € më i ulët se ai i operatorit të shpallur fitues, duke e theksuar këtë si ndikim të rëndësishëm buxhetor. Për rrjedhojë, eliminimi i tyre dhe shpallja e një ofertuesi tjetër me çmim më të lartë si fitues, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të parimit të ekonomicitetit dhe menaxhimit të drejtë të parasë publike.

Pretendimi Ankimor Nr. 2:

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili garanton trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të operatorëve ekonomikë gjatë gjithë procesit të prokurimit. Sipas ankuesit, AK nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë tenderuesit, duke e eliminuar ofertën e tyre për shkak të supozuarës mungesë të referencave, ndonëse dokumentacioni i dorëzuar tregonte qartë përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit. Ata theksojnë se arsyetimi i dhënë nga AK për eliminim nuk qëndron, pasi nga krahasimi i ofertës së tyre me kërkesat e tenderit, rezulton se ata janë një operator i përgjegjshëm që ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për projekte të ngjashme të realizuara.

Për më tepër, ata vlerësojnë se AK ka zbatuar në mënyrë të pasaktë nenin 59.4 të LPP-së, duke mos e trajtuar drejt dokumentacionin dhe duke mos marrë parasysh dëshmitë e ofruara, përfshirë referencat që sipas tyre përmbushin kriteret e kërkuara.

Ankuesi vlerëson se për dokumente me përmbajtje të ngjashme, Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim pozitiv për OE-në fituese, ndërsa ka përdorur qasje më rigoroze për ofertën e tij, duke krijuar perceptim të trajtimit të pabarabartë.

Kjo sjellje, sipas ankuesit, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj ofertës së tyre dhe favorizim të OE-së së shpallur fitues. Ata theksojnë gjithashtu se çmimi i ofertës së tyre ishte rreth 156,000 € më i ulët se ai i operatorit të shpallur fitues, çka përbën një diferencë të konsiderueshme me ndikim të rëndësishëm buxhetor dhe njëkohësisht shkelje të parimit të përdorimit efikas të fondeve publike të sanksionuar në nenin 1 dhe nenin 60 të LPP-së.

Në përfundim, ankuesi vlerëson se AK ka vepruar në mënyrë të njëanshme dhe të pabarabartë gjatë vlerësimit, duke cenuar rëndë dispozitat e nenit 7 të LPP-së dhe parimin e barazisë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Përgjigje ndaj Pretendimeve Ankimore Nr. 1 dhe Nr. 2

Nga shqyrtimi i pretendimeve të paraqitura dhe analizës së dokumentacionit të ofertës, rezulton se vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e operatorit ekonomik ankues është mbështetur në konstatimin se nuk ka përmbushur kriterin për kontrata të ngjashme. Megjithatë, nga dokumentet e dorëzuara me ofertën fillestare, vërehet se ankuesi ka paraqitur kontrata dhe referenca që përmbajnë elemente teknikisht të krahasueshme me objektin e këtij aktiviteti prokurimi. Në këtë kontekst, vlerësimi i bërë nga Autoriteti Kontraktues nuk rezulton të jetë në përputhje me nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i cili kërkon që vlerësimi të jetë i drejtë, objektiv dhe i bazuar në dokumentacionin e dorëzuar.

Gjithashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar konstatohet se oferta e operatorit ankues ka qenë më e ulët në çmim krahasuar me atë të operatorit të shpallur fitues. Në këtë mënyrë, vendimi për të shpërblyer me kontratë një operator ekonomik që rezulton më i shtrenjtë dhe që, sipas të dhënave të shqyrtuara, nuk ka përmbushur disa nga kriteret e përcaktuara në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FDT), bie në kundërshtim me nenin 60.1.1 të LPP-së. Ky nen përcakton qartë se kontrata publike duhet t'i jepet ofertës më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme që përmbushin kërkesat e dokumentacionit të tenderit.

Për më tepër, ky mospërputhje në trajtimin e ofertave ngre shqetësime serioze edhe në raport me nenin 1 të LPP-së, që ka për qëllim sigurimin e efikasitetit dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike; me nenin 6, që garanton objektivitetin dhe integritetin e autoritetit kontraktues;

si dhe me nenin 7, që ndalon çdo formë të trajtimit të pabarabartë ose diskriminues të operatorëve ekonomikë. Mosrespektimi i kritereve të përcaktuara në FDT dhe përzgjedhja e një OE-je më të shtrenjtë përkundër një oferte më të ulët dhe të mbështetur me dokumentacion të krahasueshëm, përbën shkelje të parimeve themelore të prokurimit publik dhe cënon ndjeshëm besimin në barazinë dhe transparencën e procedurës.

Pretendimi Ankimor Nr. 3:

Operatori Ekonomik ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke eliminuar ofertën e tij në mënyrë të paarsyeshme, pa vlerësuar drejt dhe objektivisht kontratat e dorëzuara si dëshmi për përvojën e kërkuar.

Sipas ankuesit, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar ofertën me arsyetimin se kontratat e ofruara nuk përmbushin kriterin e "ngjashmërisë" me objektin e kontratës, ndonëse në Dosjen e Tenderit nuk është përcaktuar shkalla e detajuar e ngjashmërisë që kërkohej. Ankuesi thekson se kërkesa ka qenë për "kontrata të ngjashme" dhe jo "të njëjta", ndaj edhe përvojat e dorëzuara – që përfshijnë punë të krahasueshme në natyrë dhe vlerë – duhet të ishin pranuar si të vlefshme.

Për më tepër, ata vlerësojnë se në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së, edhe nëse ekzistonte ndonjë devijim formal ose përshkrim jo identik, një ofertë nuk mund të eliminohet automatikisht, për aq kohë sa këto nuk përbëjnë ndryshim material në substancë. Në këtë rast, ankuesi pretendon se AK ka vepruar në mënyrë të ngushtë dhe eliminuese, pa marrë parasysh faktin që përvoja e paraqitur përputhet me kërkesat në thelb.

Në mbështetje të kësaj qasjeje, ankuesi i referohet edhe opinionit interpretues të KRPP-së lidhur me termin "të ngjashme", sipas të cilit AK ka hapësirë për të pranuar kontrata me natyrë të krahasueshme me lëndën e kontratës, për aq kohë sa kërkesa nuk ka qenë e kufizuar në mënyrë strikte.

Në përfundim, ankuesi kërkon që Paneli Shqyrtues të konstatojë se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së, duke eliminuar ofertën mbi baza jo materiale dhe në kundërshtim me parimin e vlerësimit të drejtë dhe proporcional të dokumenteve të ofertës.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 3

Sipas Fletës së të Dhënave të Tenderit (FDT), operatorët ekonomikë kanë qenë të detyruar të dëshmojnë realizimin me sukses të kontratave të ngjashme me objektin e prokurimit, në vlerë minimale prej 780,000.00 € në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Dëshmia për këtë kriter duhej të bëhej përmes listës përkatëse të kontratave të realizuara, të shoqëruar me dokumentacion mbështetës për secilën kontratë, përkatësisht kopje të kontratës, referencë, pranim teknik apo dokument tjetër përkates.

Kjo kërkesë është formuluar në mënyrë të përgjithshme përmes termit "kontrata të ngjashme", pa ndonjë përkufizim të detajuar teknik apo funksional lidhur me nivelin e ngjashmërisë së kërkuar, dhe pa ndonjë ndarje sipas kodeve të CPV-së apo natyrës së saktë të punëve që konsiderohen të ngjashme.

Autoriteti Kontraktues, gjatë vlerësimit të ofertës, ka konstatuar se kontratat dhe referencat e dorëzuara nga operatori ekonomik ankues nuk përmbushin nivelin e kërkuar të ngjashmërisë dhe nuk arrijnë vlerën minimale të përcaktuar. Për të mbështetur këtë vlerësim, AK është thirrur në Udhëzuesin nr. 002/2024 për vlerësimin e përvojës së mëparshme, duke eliminuar ofertën pa

kërkuar ndonjë informacion shtesë apo sqarim, ndonëse dokumentacioni i dorëzuar përmbante të gjitha elementet e nevojshme për verifikim dhe interpretim.

Nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankues, konstatohet se janë paraqitur listat e kontratave të realizuara gjatë periudhës përkatëse, të shoqëruara me kopje të kontratave, referenca dhe procesverbale të pranimit teknik. Nga përmbajtja e këtyre dokumenteve rezulton se një pjesë e kontratave përfshijnë pozicione të punimeve të natyrës së ngjashme me objektin e kontratës aktuale. Këto pozicione janë të krahasueshme në aspekt funksional, kompleksiteti dhe objekt përfitimi me qëllimin e kontratës në tenderin në fjalë.

Në opinionin e KRPP-së të datës 09.06.2023, të cilit i referohet edhe ankuesi, është sqaruar se termi "të ngjashme" nënkupton punë, furnizime apo shërbime që ngjajnë me ato të kontratës përkatëse në aspektin funksional, pa kërkuar identitet të plotë. Po ashtu, në të njëjtin opinion, theksohet se është kompetencë e Autoritetit Kontraktues të vlerësojë cilat kontrata konsiderohen të ngjashme, por çdo kërkesë për këtë qëllim duhet të jetë proporcionale, jo-diskriminuese dhe në funksion të ruajtjes së konkurrencës së lirë, duke respektuar parimet themelore të prokurimit publik të parashtruara në nenet 6 dhe 7 të LPP-së.

Në këtë rast, vlerësohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë një analizë përmbajtësore të dokumenteve të dorëzuara nga operatori ekonomik ankues, por ka aplikuar një interpretim të ngushtë të termit "të ngjashme" dhe standarde shtesë të nxjerra nga udhëzues i brendshëm, i cili nuk ka qenë pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit. Për më tepër, duke mos shfrytëzuar mundësinë për sqarim të parashikuar në nenin 59.4 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë kufizuese dhe jo proporcionale ndaj ofertës së operatorit.

Bazuar në dokumentet e ofertës, përmbajtjen e kontratave të dorëzuara, interpretimin e termit "të ngjashme" nga KRPP dhe moszbatimin e dispozitës së nenit 59.4 të LPP-së nga ana e AK-së, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është i bazuar. Autoriteti Kontraktues është dashur të bëjë një analizë më të thelluar të kontratave të dorëzuara dhe, në rast të ndonjë paqartësie, të kërkonte sqarim nga operatori përpara se të vendoste për eliminimin. Rekomandohet që lënda të kthehet në rivlerësim, me analizë të plotë të dokumenteve të ofertës dhe në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së.

Pretendimi Ankimor Nr. 4:

Operatori Ekonomik ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke aplikuar kritere të pabarabarta gjatë vlerësimit të tenderëve, si dhe duke mos zbatuar standarde të njëjta për të gjithë tenderuesit. Sipas ankuesit, tenderi i tyre është eliminuar padrejtësisht, ndonëse kanë ofruar dokumentacion të plotë dhe ofertë me çmimin më të ulët, ndërsa janë toleruar mangësi serioze në ofertat e disa grupeve të tjera të operatorëve ekonomikë, përfshirë edhe atë të shpallur fitues. Ankuesi rendit konkretisht mangësitë që duhej të çonin në eliminimin e tenderëve të tjerë, si në vijim:

Grupi i OE "Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K.":

Anëtari Eco Clean (Muhamet Muçiqi B.I.) nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për kontrata të ngjashme.

Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Nr. 05/L-132 (vetëm me regjistrim "DUD").

CV-ja e dorëzuar për teknikun është e pa-nënshkruar dhe pa informatat e nevojshme.

Grupi i OE "AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Rexha":

Anëtari Multi Business Group SH.P.K. ka paraqitur raport të vlerësimit të riskut, por mungon licenca e kompanisë së licencuar për siguri dhe shëndet në punë.

Marrëveshjet për pajisje mungojnë emërtimet e pajisjeve.

Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Nr. 05/L-132.

Mungon marrëveshja me NTSH "Gjyli Komerc".

Grupi i OE "N & B SH.P.K.; BM Group SH.P.K.":

Mungon dëshmia e mjaftueshme për kontrata të ngjashme.

Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Nr. 05/L-132 (vetëm DUD).

Gjithashtu, edhe Grupi i OE "BEREQETI-ING; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.", i shpallur fitues nga AK, sipas ankuesit, ka paraqitur tender me mangësi të shumta, si:

Vlerësuesi i riskut posedon licencë, por mungojnë certifikatat përkatëse sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Nr. 05/L-132 (vetëm DUD).

Kamioni për bartje i ofruar nuk është në përputhje me kërkesën e dosjes – është ofruar kamionetë me plato, ndërsa në librezen e dorëzuar figuron "kamionetë dypellkabinë me dy dyer".

Punëtorët fizikë nuk i përmbushin kriteret – mungojnë kontratat për të gjithë stafin fizik të paraqitur në listë, përfshirë edhe teknikët.

Sipas ankuesit, nëse AK do të kishte vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë të gjitha ofertat, oferta e tyre – e cila sipas tyre përmbush të gjitha kërkesat e dosjes dhe ka çmimin më të ulët ndër të gjithë tenderët përgjegjës – do të duhej të ishte shpërblyer me kontratë. Mospranimi i tenderit të tyre dhe tolerimi i mangësive në ofertat tjera, përbën një shkelje të qartë të nenit 59 të LPP-së, si dhe cenim të parimit të barazisë në trajtimin e tenderuesve.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 4

Pretendimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankues lidhet me aplikimin e standardeve të dyfishta gjatë vlerësimit të ofertave nga ana e Autoritetit Kontraktues, në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe parimin e trajtimit të barabartë. Ankuesi pretendon se, ndonëse ka dorëzuar ofertë të plotë dhe me çmimin më të ulët, është eliminuar padrejtësisht, ndërkohë që janë toleruar mangësi në ofertat e operatorëve të tjerë, përfshirë grupin e shpallur fitues.

Në vijim paraqitet analiza për secilin nga grupet e përmendura në pretendim:

1. Grupi OE "Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K."

Për kontratat e ngjashme: Pretendimi nuk qëndron, pasi në dokumentet e tenderit nuk është kërkuar që çdo anëtar i grupit të dëshmojë përvojë individualisht. Sipas nenit 26.5 të Rregullores për Prokurim Publik, në mungesë të një kërkese të shprehur, përvoja trajtohet në nivel grupi.

Për damperat: Pretendimi se damperat janë të regjistruar vetëm me "DUD" nuk paraqet shkelje. Sipas Aneksit 8 të DT-së, është kërkuar të dorëzohet së paku një dokument që vërteton pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit (si libreza, faturë, deklaratë doganore, marrëveshje qiraje). Nëse është dorëzuar një prej tyre, kriteri konsiderohet i përmbushur.

Për CV-në e teknikëve: Është konstatuar se CV-ja e një tekniku është e pa nënshkruar. Kjo përbën një mospërputhje formale që kërkon vlerësim të kujdesshëm nëse përbën devijim të vogël jo-material sipas nenit 59.4 të LPP-së. Në këtë rast, AK është dashur të kërkojë sqarim dhe jo të penalizojë ofertën automatikisht, për të siguruar një vlerësim proporcional dhe të drejtë.

2. Grupi OE “AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Rexha”

Raporti i vlerësimit të riskut: Pretendimi është i pabazuar. Është dorëzuar raport i hartuar nga OZON Space SH.P.K., kompani e licencuar me nr. 23/2021, dhe është përmbushur kërkesa e dosjes.

Emërtimi i pajisjeve në marrëveshje: Pretendimi është i pabazuar. Lista e pajisjeve të dorëzuara përmban të gjitha të dhënat sipas Aneksit 8 dhe identifikon qartë pronësinë ose qiranë për secilën pajisje.

Për damperat: Për një damper është dorëzuar marrëveshje për shfrytëzim të mbështetur me deklaratë doganore, ndërsa për tjetrin është dorëzuar faturë blerjeje. Kjo përputhet me kërkesat e Aneksit 8 të DT-së.

Për marrëveshjen me NTSH “Gjyli Komerc”: Pretendimi nuk qëndron, pasi marrëveshja është pjesë e ofertës së dorëzuar.

3. Grupi OE “N & B SH.P.K.; BM Group SH.P.K.”

Për kontratat e ngjashme: Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, janë dorëzuar dëshmi dhe referenca që mbështesin realizimin e kontratave të krahasueshme me objektin e tenderit.

Për damperat: Pretendimi është i pabazuar. Nëse është dorëzuar një dokument si DUD doganor që vërteton të drejtën e përdorimit të mjetit, kërkesa është përmbushur sipas Aneksit 8.

4. Grupi OE “BEREQETI-ING; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.” (i rekomanduar për kontratë)

Certifikatat për siguri dhe shëndet në punë: Është dorëzuar vetëm raporti i vlerësimit të riskut, por mungojnë certifikatat e sigurisë dhe shëndetit në punë, të kërkuara në FDT. Kjo është një mangësi që duhej të trajtohej përmes sqarimit sipas nenit 59.4 të LPP-së përpara marrjes së vendimit për përgjegjshmëri.

Për damperat: Pretendimi nuk qëndron, për arsye se dokumentacioni i dorëzuar (DUD doganor ose dokument tjetër i pranueshëm) përmbush kërkesat e Aneksit 8.

Për mjetin për bartjen e mbeturinave: Nga analiza e dokumenteve, rezulton se është dorëzuar kamionetë dypellkabinë me dy dyer, ndërkohë që kërkesa në DT ishte për “kamion për bartjen e

mbeturinave”. Kjo përbën devijim nga kërkesat teknike dhe përbën mospërputhje me specifikimet e kontratës.

Punëtorët fizik dhe teknikë: Për punëtorët fizik është kërkuar vetëm lista e stafit, pa obligim për kontrata individuale, dhe kjo listë është dorëzuar. Për pozitat teknike, janë dorëzuar kontrata pune, duke plotësuar kërkesat e dokumentacionit të tenderit.

Nga analiza e pretendimeve dhe e dokumentacionit të ofertave, vlerësohet se Autoriteti Kontraktues në disa raste ka vepruar në përputhje me kriteret e tenderit, ndërsa në raste të tjera ka zbatuar në mënyrë të pabarabartë nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të Rregullores për Prokurim Publik, duke mos kërkuar sqarime për mangësi të natyrës jo-thelbësore dhe duke toleruar mospërputhje për operatorë të caktuar.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi Ankimor Nr. 4 është pjesërisht i bazuar dhe rekomandon që vlerësimi të rishqyrtohet, duke siguruar zbatim të barabartë të standardeve për të gjithë operatorët dhe përdorim të mekanizmave për sqarim sipas nenit 59.4 të LPP-së, në frymën e barazisë, proporcionalitetit dhe transparencës

Pretendimi Ankimor Nr. 5:

Operatori Ekonomik ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke mos respektuar parimin themelor të renditjes dhe shpërblimit me kontratë të ofertës më të ulët ndër tenderët e cilësuar si të përgjegjshëm. Sipas ankuesit, oferta e tyre përmbush në tërësi të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, dhe për këtë arsye duhet të ishte vlerësuar si ofertë e përgjegjshme, në përputhje me nenin 59 të LPP-së. Për më tepër, çmimi i ofruar nga ana e tyre është më i ulët për së paku 20%, ose shprehur në vlerë absolute, për rreth 156,000.00 €, krahasuar me çmimin e ofertës së OE-së së shpallur fitues. Mosrespektimi nga ana e AK-së i këtij rendi logjik të vlerësimit – fillimisht vlerësimi i përgjegjshmërisë, e më pas renditja sipas çmimit më të ulët – përbën, sipas ankuesit, një shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 60 të LPP-së, i cili përcakton qartë se kontrata i shpërblehet operatorit ekonomik që ka paraqitur ofertën më të ulët nga radhët e ofertave të përgjegjshme dhe të përshtatshme. Në këto rrethana, mungesa e vlerësimit të drejtë dhe objektiv të ofertës së tyre, si dhe shpërblimi me kontratë i një tenderuesi më të shtrenjtë, përbën shkelje të parimeve të ekonomisë dhe efikasitetit në shfrytëzimin e fondeve publike, të garantuara me nenin 1 dhe nenin 60 të LPP-së.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 5

Operatori Ekonomik ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke mos shpërblyer me kontratë ofertën e tyre, e cila, sipas tyre, është më e ulëta financiarisht ndër ofertat e paraqitura dhe njëkohësisht përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Nga shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe dokumentacionit të ofertës së operatorit ankues, është konstatuar se Autoriteti Kontraktues nuk e ka vlerësuar ofertën në pajtim me nenin 59 të LPP-së, duke eliminuar operatorin për mangësi që, sipas analizës së mëparshme, mund të klasifikohen si paqartësi apo devijime të vogla, të trajtueshme në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së.

Duke pasur parasysh se vet Autoriteti Kontraktues, në Fletën e të Dhënave të Tenderit, ka përcaktuar si kriter vlerësimi çmimin më të ulët, mosvlerësimi i drejtë i ofertës së operatorit ankues ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin përfundimtar të aktivitetit të prokurimit. Nga të dhënat në platformën elektronike të prokurimit, oferta e operatorit ekonomik ankues është më e volitshme financiarisht në krahasim me ofertën e operatorit të shpallur fitues.

Kjo situatë bie ndesh me parashikimet e nenit 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton qartë:

Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës

1.Autoriteti kontraktues do t'ia japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Për këtë arsye, rekomandohet që Autoriteti Kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ankues në përputhje me nenin 59 të LPP-së, kriteret e përcaktuara në FDT dhe nenin 60 të LPP-së, duke garantuar që shpërblimi me kontratë të bëhet në mënyrë të ligjshme dhe në përputhje me parimet e barazisë, transparencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

PËRFUNDIM

Mbështetur në analizën e pretendimeve të ngritura dhe dokumentacionit të shqyrtuar, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa meriton të pranohet si e bazuar. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore janë identifikuar mospërputhje në mënyrën se si Autoriteti Kontraktues ka interpretuar përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit nga ana e operatorit ankues, në veçanti sa i përket kontratave të ngjashme, për të cilat ky i fundit është eliminuar.

Në këtë kontekst, nuk mund të konstatohet se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me standardin e përcaktuar në nenin 59.4 dhe nenin 60 të LPP-së, veçanërisht kur vetë kriteri i dhënies së kontratës ka qenë çmimi më i ulët ndër ofertat e përgjegjshme.

Për më tepër, gjatë shqyrtimit të përgjithshëm të procesit të vlerësimit janë evidentuar edhe elementë që ngrenë dyshime për qasje jo të njëjtë në vlerësimin e ofertave të tjera, çka përforcon nevojën për rivlerësim gjithëpërfshirës dhe të paanshëm.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues propozon që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe që lënda të kthehet në rivlerësim, duke garantuar zbatimin e plotë të kërkesave të dokumentacionit të tenderit dhe dispozitave përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, në veçanti neneve 1, 6, 7, 59 dhe 60, si dhe trajtim të barabartë, transparent dhe të drejtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AGRO INVEST 1" SH.P.K Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0657 ka vlerësuar se:

PËRSHKRiMI I ANKESËS

Ankesa nr. 2025/0657 është parashtruar nga GOE "AGRO INVEST 1" SH.P.K & "Rexha" SH.P.K & "Multi Business Group" SH.P.K kundër vendimit të Komunës së Prishtinës për aktivitetin "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës". Ankuesi pretendon se është eliminuar padrejtësisht, megjithëse ka dorëzuar kontrata të përfunduara me vlerë mbi 1.9

milionë euro, të cilat dëshmojnë përvojën e kërkuar. Po ashtu, ankuesi pretendon se ka dorëzuar marrëveshje bashkëpunimi për stafin teknik dhe profesional, të cilat AK i ka refuzuar pa bazë ligjore. Sipas ankuesit OE i shpallur fitues nuk i përmbush kërkesat e dosjes, sepse ka ofruar kontrata nën vlerën minimale të kërkuar, mungesë pajisjesh dhe dokument të dyshuar si të falsifikuar. Ankuesi kërkon anulimin e vendimit dhe rivlerësim të ofertave.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të paraqitura nga grupi i operatorëve ekonomikë "AGRO INVEST 1" SH.P.K; "Rexha" SH.P.K dhe "Multi Business Group" SH.P.K kundër Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës". Pas shqyrtimit të ankesës me nr. 2025/0657, dokumentacionit të dorëzuar dhe të dhënave në platformën e prokurimit, eksperti shqyrtues paraqet vlerësimin për secilin pretendim si më poshtë:

Pretendimi Ankimor Nr. 1:

(Mospërfillja e marrëveshjeve për stafin profesional dhe teknik - pika 9.1 & 9.2 e FDT-së)

Operatori Ekonomik ankues kundërshton vlerësimin e Autoritetit Kontraktues (AK), sipas të cilit nuk është përmbushur kërkesa për dëshmimin e kontratave të ngjashme në vlerë prej 780,000.00 € të realizuara brenda tre viteve nga njoftimi për kontratë. Sipas ankuesit, janë dorëzuar kontrata të shumta nga të gjithë anëtarët e konsorciumit – "Agro Invest 1" SH.P.K., "Rexha" SH.P.K. dhe "Multi Business Group" SH.P.K. – të shoqëruara me raporte përfundimtare, referenca dhe procesverbale të pranimit teknik, për të vërtetuar realizimin me sukses të punëve të ndërtimit me natyrë identike ose të ngjashme me objektin e kësaj procedure.

Ankuesi liston nëntë kontrata konkrete të realizuara nga anëtarët e grupit, të gjitha të kryera sipas ankuesit brenda afatit 3-vjeçar dhe me vlerë totale mbi 1,900,000.00 €, përfshirë projekte ndërtimi të parqeve, objekteve rekreative, infrastrukturës urbane dhe rrethojave. Të gjitha këto punë përputhen për nga natyra me kodin CPV 45000000-7 – Punë ndërtimore, që është edhe kodi i kësaj procedure.

Sipas ankuesit, vendimi i AK-së është i pabazuar dhe në kundërshtim me nenin 48 par.1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), pasi nuk përmban asnjë analizë individuale të dokumenteve të dorëzuara, nuk përmend asnjë kontratë apo referencë specifike, dhe nuk sqaron se për cilën arsye secili dokument nuk është konsideruar i vlefshëm. AK është mjaftuar me një përgjigje të përgjithësuar, pa bërë vlerësim të thelluar për secilën dëshmi.

Për këtë arsye, ankuesi konsideron se është përmbushur plotësisht kriteri i përcaktuar në pikat 9.1 dhe 9.2 të FDT-së, dhe se vendimi i AK-së është i paligjshëm, i paarsyetuar dhe në kundërshtim me parimet e transparencës dhe vlerësimit të drejtë.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 1

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të dëshmojnë se kanë përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, me vlerë minimale prej 780,000.00 €, në periudhën 3 (tri) vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Kjo kërkesë nuk kufizon llojin e kontratave vetëm në ato identike, por përfshin edhe ato që janë për nga natyra të krahasueshme dhe të ngjashme me objektin e kontratës.

Në vendimin për eliminimin e grupit të operatorëve ekonomikë “AGRO INVEST 1 SH.P.K.”, “REXHA SH.P.K.” dhe “MULTI BUSINESS GROUP SH.P.K.”, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se ky grup nuk i ka përmbushur kërkesat e FDT-së sa i përket kontratave të ngjashme me vlerë minimale 780,000.00 €, të realizuara gjatë tre viteve të fundit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së operatorit ekonomik ankues – konsorciumi “AGRO INVEST 1 SH.P.K.”, “REXHA SH.P.K.” dhe “MULTI BUSINESS GROUP SH.P.K.” – eksperti ka evidentuar se secili nga anëtarët e grupit ka paraqitur nga një listë të kontratave të realizuara, të pajisura me kontrata përkatëse, referenca, raporte përfundimtare dhe procesverbale pranimi të cilat mbulojnë projekte të ndryshme, që për nga natyra hyjnë brenda sferës së punëve të ngjashme.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në platformën e prokurimit elektronik, konstatohet se vendimi për eliminim nuk është i shoqëruar me një arsyetim të detajuar dhe të individualizuar për secilën nga kontratat e dorëzuara, dhe nuk janë identifikuar qartë elementet konkrete që janë vlerësuar si të pamjaftueshme nga Autoriteti Kontraktues. Një trajtim më i qartë dhe më i ndarë për secilën dëshmi do të siguronte më shumë transparencë dhe qartësi në proces.

Për më tepër, në rast të ndonjë paqartësie apo mungese në përmbajtjen e dokumentacionit, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësinë që, në përputhje me nenin 59.2 dhe nenin 72.3 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe nenin 10.1 të Udhëzuesit Operativ, të kërkojë sqarime shtesë për të mundësuar një vlerësim të plotë dhe të drejtë.

Në bazë të analizës së bërë dhe dokumentacionit të shqyrtuar, eksperti shqyrtues vlerëson se vendimi për eliminim nuk është mbështetur në një analizë të detajuar dhe nuk është shoqëruar me arsyetim të mjaftueshëm për refuzimin e ofertës së operatorit ekonomik ankues. Për rrjedhojë, pretendimi ankimor vlerësohet si i bazuar, dhe rekomandohet kthimi i lëndës në rivlerësim, në përputhje me parimet e transparencës, barazisë dhe objektivitetit në vlerësim.

Pretendimi Ankimor Nr. 2:

(Mospërfillja e marrëveshjeve për stafin profesional dhe teknik - pika 9.1 & 9.2 e FDT-së)

Operatori Ekonomik ankues kundërshton konstatimin e Autoritetit Kontraktues se marrëveshjet e dorëzuara për stafin profesional dhe teknik nuk përmbajnë elementet e nevojshme të një parakontrate pune dhe mungojnë anekse në përputhje me Ligjin nr. 03/L-212 për Marrëdhëniet e Punës. Sipas ankuesit, ky pretendim është i pabazuar, i padrejtë dhe në kundërshtim me nenin 48 par. 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), pasi marrëveshjet e paraqitura përmbajnë të gjitha elementet thelbësore për të dëshmuar ekzistencën e një marrëdhënieje pune të vlefshme.

Marrëveshjet e bashkëngjitura nga grupi i operatorëve përmbajnë: emrin e projektit për të cilin bëhet bashkëpunimi, datën e lidhjes, të dhënat e plota të personit të angazhuar (emër, mbiemër, pozicion, detyrë), vlefshmërinë e marrëveshjes deri në përfundimin e projektit dhe nënshkrimet e palëve. Ankuesi thekson se Ligji nr. 03/L-212 nuk kërkon përfshirjen e ndonjë “aneksi” për vlefshmërinë e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe një kërkesë e tillë nuk parashihet as në dosjen e tenderit.

Sipas ankuesit, AK ka interpretuar në mënyrë të padrejtë kërkesat e dosjes, duke aplikuar standarde që nuk janë të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe duke diskriminuar operatorin

ankues përballë operatorit të rekomanduar për kontratë. Marrëveshjet e dorëzuara janë të lidhura ekskluzivisht për këtë procedurë – "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" – dhe janë në përputhje me qëllimin për të dëshmuar kapacitetin teknik dhe profesional.

Po ashtu, nëse marrëveshjet e dorëzuara do të konsideroheshin të paplota, AK ishte i obliguar të kërkonte sqarim apo plotësim, në përputhje me nenin 59.2 të LPP-së, e jo të konstatonte mungesë të dokumentacionit që vetë e ka pranuar.

Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesi rishtron të gjitha marrëveshjet me stafin profesional (inxhinier ndërtimi, inxhinier i makinerisë, gjeodet) dhe me stafin teknik të certifikuar (teknikë ndërtimi, teknikë makinerie, saldues, punëtorë teknikë), duke vërtetuar se kërkesa për kapacitetin njerëzor është përmbushur në tërësi.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 2

Eksperti shqyrtues, pas analizës së pretendimit të operatorit ekonomik ankues dhe të dokumentacionit të ofertës së dorëzuar në platformën e prokurimit elektronik, paraqet vlerësimin në lidhje me konstatimin e Autoritetit Kontraktues për mosplotësimin e kërkesës për dëshmimin e stafit profesional dhe teknik, sipas pikave 9.1 dhe 9.2 të Fletës së të Dhënave të Tenderit.

Sipas pikës 9.1 dhe 9.2 të Fletës së të Dhënave të Tenderit (FDT), operatorët ekonomikë janë kërkuar të dëshmojnë:

"Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët."

Në dokumentacionin e ofertës, operatori ekonomik ankues ka dorëzuar marrëveshje bashkëpunimi për të gjithë stafin profesional dhe teknik, të lidhura në emër të projektit konkret "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës". Të gjitha marrëveshjet janë të firmosura nga të dy palët dhe përmbajnë zotim të qartë të bashkëpunëtorit për angazhim gjatë zbatimit të këtij projekti.

Ligjërisht, marrëveshja bashkëpunimi është një akt juridik i vlefshëm që shpreh pajtimin e vullnetit ndërmjet dy palëve dhe e lidh operatorin me personin e angazhuar për projektin. Prandaj, në mungesë të një përkufizimi më të ngushtë në FDT, ajo duhet të konsiderohet e barasvlershme me kontratën e kërkuar, për sa kohë plotëson kërkesën për nënshkrim nga të dy palët dhe është e lidhur për projektin konkret.

Referenca e Autoritetit Kontraktues në arsyetimin mbi eliminimim në Ligjin e Punës (03/L-212), ku pretendohet se kontrata duhet të përfshijë elemente si kompensimi, orari i punës, pushimi vjetor apo ndërprerja e kontratës, nuk qëndron në këtë kontekst. Kjo pasi asnjë nga këto elemente nuk është kërkuar në FDT, dhe interpretimi i tillë përbën vendosje të kritereve shtesë në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së.

Duke qenë se marrëveshjet e dorëzuara nga OE ankues janë të lidhura për projektin konkret, të firmosura nga të dy palët dhe dëshmojnë angazhimin e stafit për realizimin e kontratës, eksperti shqyrtues vlerëson se eliminimi i OE-së nuk është i bazuar dhe ka ardhur si rezultat i interpretimit të ngushtë dhe jo proporcional të kërkesës në FDT. Prandaj, pretendimi vlerësohet si i bazuar.

Pretendimi Ankimor Nr. 3:

(Papërgjegjshmëria e Grupit të Operatorëve Ekonomikë “BEREQETI ING SH.P.K & AAB CONSTRUCTION SH.P.K.”)

Mungesa e përmbushjes së kërkesës për kontrata të ngjashme

Ankuesi pretendon se GOE i shpallur fitues nuk e përmbush kërkesën për kontrata të ngjashme në vlerë minimale 780,000.00 €, siç parashihet në Fletë të Dhënave të Tenderit (FDT). Nga verifikimi i kontratave të dorëzuara nga lideri BEREQETI ING SH.P.K dhe anëtari AAB CONSTRUCTION SH.P.K rezulton se totali i tyre është 206,391.60 €, që përbën një vlerë shumë më të ulët sesa ajo e kërkuar. Ankuesi thekson se këto kontrata kanë të bëjnë me rrethime dhe punime përkatëse, por nuk përmbushin kufirin minimal të përcaktuar në DT, andaj konsideron se operatori i rekomanduar është dashur të eliminohet për mosplotësim të këtij kriteri.

Mungesa e mjeteve sipas Aneksit 8 – Kamioneta për mbeturina

Sipas Aneksit 8 të Dosjes së Tenderit, kërkohet një kamionetë për bartjen e mbeturinave. GOE ka paraqitur një librezë mjeti për një “Kamionetë dubelkabine me 3 dyer” të tipit Volkswagen VW, me peshë 2650 kg. Ankuesi pretendon se ky mjet është i dedikuar për transportin e punëtorëve dhe jo për mbeturina, siç edhe dëshmohet nga përshkrimi teknik dhe fotografia e dorëzuar. Si rrjedhojë, ky mjet nuk e përmbush kërkesën specifike të tenderit dhe operatori duhet të ishte shpallur i papërgjegjshëm.

Mungesa e pajisjes për përzierje betoni për eskavator

Gjithashtu, në pikën 12 të Aneksit 8 kërkohet një pajisje për përzierje betoni për eskavator. Sipas ankuesit, GOE nuk ka dorëzuar asnjë dokument që dëshmon se posedon këtë pajisje. Ky mungesë përbën mospërmbushje të qartë të kërkesës dhe paraqet një arsye të mjaftueshme për eliminimin e ofertës.

Dokument i falsifikuar për mekanizëm pune – shkelje e rëndë

Në pikën 8 të Aneksit 8 kërkohet një “Kamion Kipper me Kran”. Kompania ankues ka ofruar marrëveshje të vlefshme me SEFERI GROUP SH.P.K dhe librezën përkatëse. Megjithatë, GOE i shpallur fitues ka paraqitur të njëjtën librezë mjeti me një “marrëveshje” të dyshimtë me SEFERI GROUP SH.P.K., e cila sipas ankuesit është e falsifikuar, pa leje dhe pa marrëveshje reale me pronarin e mjetit. Ankuesi e cilëson këtë veprim si falsifikim të pastër të dokumentit – me vulë dhe nënshkrim të falsifikuar – dhe e konsideron si shkelje të rëndë të Ligjit për Prokurim Publik.

Dyshime për marrëveshje të qëllimshme mes AK dhe GOE

Në fund, ankuesi shpreh dyshime serioze se ekziston një marrëveshje e qëllimshme dhe e paligjshme mes AK-së dhe GOE-së së shpallur fitues. Kjo për shkak të tolerimeve në vlerësim, pavarësisht mangësive serioze në ofertën e tyre.

Përfundimisht, sipas ankuesit, GOE “BEREQETI ING SH.P.K & AAB CONSTRUCTION SH.P.K.” është dashur të shpallet i papërgjegjshëm për shkak të mospërmbushjes së kritereve të kërkuara dhe përfshirjes në veprime të cilat cenojnë ligjshmërinë e procesit të prokurimi

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 3

Eksperti shqyrtues, pas analizës së pretendimeve të paraqitura nga operatori ekonomik ankues dhe shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së grupit të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues në platformën e prokurimit elektronik, paraqet vlerësimin për secilën nga çështjet e ngritura, në lidhje me përputhshmërinë e ofertës me kërkesat e dokumentacionit të tenderit dhe me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik.

1. Mungesa e përmbushjes së kërkesës për kontrata të ngjashme

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues se grupi i operatorëve ekonomikë të shpallur fitues nuk ka përmbushur kriterin për kontrata të ngjashme me vlerë minimale 780,000.00 €, vlerësohet si i pabazuar.

Sipas Fletës së të Dhënave të Tenderit (FDT), është kërkuar:

"Kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, me vlerë të përgjithshme mbi 780,000.00 € në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, të shoqëruara me listën përkatëse dhe dokumentet mbështetëse si kontrata, referenca apo procesverbale pranimi."

Kjo kërkesë nuk kufizon vlerësimin vetëm në kontrata identike, por përfshin edhe kontrata që janë teknikisht dhe financiarisht të krahasueshme me objektin e prokurimit. Grupi i OE-ve të shpallur fitues ka dorëzuar dokumentacion mbështetës në përputhje me këtë kërkesë, përfshirë listën përkatëse të kontratave dhe referenca teknike.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, vlerësohet se kërkesa për kontrata të ngjashme është përmbushur në përputhje me kriterin e përcaktuar në FDT.

2. Kamion për bartjen e mbeturinave

Sipas FDT-së është kërkuar qartazi:

"Kamion për bartjen e mbeturinave (1 copë)".

Grupi i OE-ve ka dorëzuar librezën e një kamionete  dubelkabinë dhe ka bashkëngjitur një fotografi të mjetit - ndërkohë është kërkuar kamion. Po ashtu, mungon çdo dëshmi teknike që ky mjet është funksionalisht i përshtatshëm për bartjen e mbeturinave – si për shembull kontenier i montuar, mekanizëm ngritës, strukturë për ngarkim-shkarkim apo ndonjë pajisje tjetër ndihmëse.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se mjeti i ofruar nuk përmbush kërkesën e përcaktuar për "kamion për bartjen e mbeturinave".

3. Pajisje për përzierje betoni për ekskavator

Sipas Aneksit 8 të Dosjes së Tenderit është kërkuar:

"Pajisje për përzierje betoni për ekskavator (1 copë)".

Grupi i OE-ve ka përfshirë në listën e mekanizmave dy përzierëse betoni me kapacitet 0.5 $m^3$, por nuk është ofruar asnjë specifikim që këto pajisje janë të destinuara për montim në ekskavator apo që janë të përshtatshme për përdorim në mënyrë të integruar me ekskavatorin.

Në mungesë të këtyre specifikimeve, dhe për shkak të mungesës së dëshmive për përputhshmëri me kërkesën teknike, eksperti shqyrtues vlerëson se kjo kërkesë nuk është përmbushur.

4. Dokument i dyshuar si i falsifikuar – Kamion Kipper me Kran

Pretendimi i operatorit ankues lidhet me faktin se grupi i OE-ve të shpallur fitues ka dorëzuar të njëjtën librezë mjeti që është dorëzuar edhe nga vetë OE ankues për mjetin "Kamion Kipper me Kran", shoqëruar me një "marrëveshje bashkëpunimi" me SEFERI GROUP SH.P.K., të cilën ankuesi e konsideron të falsifikuar dhe të paautorizuar.

Megjithatë, përtej pretendimit të shkruar, OE ankues nuk ka ofruar ndonjë provë materiale plotësuese që do ta përforconte pretendimin për falsifikim – siç do të ishte një deklaratë e pronarit të mjetit, një kallëzim penal apo ndonjë dokument zyrtar që vërteton pavlefshmërinë e marrëveshjes.

Ligji për prokurimin publik nuk e ndalon që një palë e tretë të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me më shumë se një operator ekonomik, për aq kohë sa marrëveshjet janë të vlefshme dhe të dokumentuara.

Eksperti shqyrtues nuk ka kompetencë për të konstatuar falsifikime të dokumenteve, por vlerëson se në këtë rast ekzistojnë rrethana që meritojnë sqarim shtesë. Rekomandohet që Autoriteti Kontraktues, për të garantuar integritetin e procesit, të kontaktojë SEFERI GROUP SH.P.K. për të vërtetuar vlefshmërinë e marrëveshjes dhe pronësinë e mjetit, në mënyrë që të shmangen dyshimet dhe të sigurohet një proces vlerësimi transparent dhe i besueshëm.

5. Dyshime për marrëveshje të qëllimshme mes AK-së dhe GOE-së

Operatori ekonomik ankues ka shprehur dyshime për ekzistencën e një marrëveshjeje të qëllimshme dhe të paligjshme ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe grupit të OE-ve të shpallur fitues, të bazuara në atë që ai e konsideron si tolerim të pajustifikuar të mangësive

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendime të kësaj natyre nuk mund të merren në konsideratë në mungesë të provave konkrete dhe nuk bëjnë pjesë në kompetencën e shqyrtimit administrativ të një procedure prokurimi.

Nëse operatori ekonomik ankues posedon prova, indicie apo fakte të bazuara që mund të vërtetojnë një marrëveshje të tillë të paligjshme, ai ka të drejtë të drejtohet pranë organeve kompetente, si Policia apo Prokuroria

Në kuadër të shqyrtimit të kësaj procedure, ky pretendim nuk mbështetet me fakte të verifikueshme dhe nuk ndikon në ligjshmërinë e vlerësimit të ofertës nga Autoriteti Kontraktues.

Mbështetur në analizën e pretendimeve të paraqitura dhe dokumentacionit të ofertës së grupit të OE-ve të shpallur fitues, eksperti shqyrtues vlerëson se ekzistojnë mospërputhje të qarta në disa nga pozitat e kërkuara në Aneksin 8 të DT-së, të cilat ndikojnë në përputhshmërinë teknike të ofertës. Po ashtu, për disa elemente të tjerë të ofertës, vlerësohet se është e nevojshme ndërmarrja e veprimeve shtesë verifikuese nga ana e Autoritetit Kontraktues, në mënyrë që të sigurohet respektimi i parimeve të barazisë dhe transparencës gjatë vlerësimit.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues rekomandon që Autoriteti Kontraktues të rivlerësojë ofertën e grupit të OE-ve të shpallur fitues në përputhje me kërkesat e dokumentacionit të tenderit dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit dhe ruajtjen e integritetit të procedurës.

PËRFUNDIM

Mbështetur në arsyet e lartcekura, eksperti shqyrtues propozon që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Gjatë shqyrtimit është konstatuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka garantuar zbatimin e plotë të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenit 40 të Rregullores për Prokurim Publik, në lidhje me ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave. Po ashtu, nuk është siguruar trajtim i barabartë dhe jo-diskriminues për operatorët ekonomikë, gjë që përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore është vërejtur se vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës një operatori ekonomik me çmim dukshëm më të lartë dhe me mangësi të konsiderueshme në dokumentacion nuk është në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit, të përshkruara në nenin 6 të LPP-së, si dhe me qëllimin e përgjithshëm të prokurimit publik, të parashikuar në nenin 1 të këtij ligji.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues propozon rivlerësimin e ofertave, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe dokumentacionin e tenderit, duke garantuar trajtim të barabartë, transparencë dhe vlerësim të drejtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “N & B” SH.P.K Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0660 ka vlerësuar se:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Operatori ekonomik “N&B” SH.P.K. ka paraqitur ankesë ndaj vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrethojave të varrezave”, me pretendimin se është eliminuar padrejtësisht nga gara për shkak të mungesës së nënshkrimit në CV-në e një salduesi. Sipas ankesës, kjo përbën devijim të vogël që nuk cenon përmbajtjen dhe nuk justifikon eliminimin pa kërkim të sqarimeve shtesë, duke u kundërshtuar kështu neni 59, 69 dhe 72 i LPP-së. Njëkohësisht, ankuesi thekson se OE i shpallur fitues ka mospërputhje serioze me kërkesat e dosjes së tenderit në disa pozita të stafit teknik, mungesë të certifikatave të sigurisë, CV jo të plota dhe mungesë të pajisjeve të obligueshme sipas Aneksit 8. Ankesa thekson se AK ka aplikuar standarde të dyfishta, duke mos trajtuar ofertuesit në mënyrë të barabartë dhe në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 1 të LPP-së. Po ashtu, kritikohet vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si i paarsyetuar dhe në kundërshtim me nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik. Në përfundim, kërkohet anulimi i vendimit të dhënies së kontratës dhe kthimi i lëndës në rivlerësim të plotë dhe të drejtë.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të paraqitura nga operatori ekonomik “N&B” SH.P.K. kundër Autoritetit Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në lidhje me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”. Pas shqyrtimit të ankesës me nr. 2025/0660, të gjitha dokumenteve të dorëzuara nga palët dhe të dhënave në platformën e prokurimit elektronik, eksperti shqyrtues paraqet analizën

dhe vlerësimet në vijim:

Pretendimi Ankimor Nr. 1

Operatori Ekonomik ankues konteston vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e tij nga procedura e prokurimit, me arsyetimin se një nga salduesit e ofruar, z. Lavdim Babaj, nuk e ka nënshkruar CV-në personale. Ankuesi thekson se dokumentacioni i dorëzuar është i plotë dhe përmban të gjitha elementet thelbësore të kërkuara nga Dosja e Tenderit, përkatësisht:

Certifikatën ISO 9606;

Kontratën e punës të nënshkruar nga të dy palët;

Biogafinë profesionale (CV-në) të kandidatit.

Ankuesi thekson se mungesa e një nënshkrimi në CV nuk cenon përmbajtjen apo vlefshmërinë e dokumentit dhe, në përputhje me Udhëzuesin nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, rasti në fjalë është kategorizuar si situatë për të cilën mund të kërkohen informata sqaruese, në përputhje me nenin 10.1 të udhëzuesit.

Po ashtu, ankuesi i referohet nenit 59.4 të LPP-së, sipas të cilit një ofertë nuk duhet të eliminohet për devijime të vogla që nuk ndikojnë në përputhjen me kërkesat thelbësore të dosjes së tenderit. Gjithashtu, ai thirret në nenet 59 dhe 72 të LPP-së, duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me to, pasi nuk ka kërkuar sqarim shtesë lidhur me mungesën e nënshkrimit në CV, edhe pse kjo mospërputhje nuk e cenonte përmbajtjen e dokumentit.

Në fund, ankuesi pretendon se veprimi i AK-së përbën një trajtim të pabarabartë dhe përjashtim të pajustifikuar nga gara për një devijim të vogël, në kundërshtim edhe me nenin 7 të LPP-së, duke cenuar barazinë në trajtim të operatorëve ekonomikë dhe duke eliminuar ofertën më të lirë nga konkurrenca.

Për rrjedhojë, kërkohet që AK të kishte vepruar sipas udhëzuesit dhe ligjit, duke kërkuar sqarim dhe jo duke eliminuar ofertën.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 1

Në Dosjen e Tenderit, në seksionin “Kapaciteti Teknik dhe Profesional”, për pozitën “Saldues i certifikuar sipas standardit ISO EN ISO 9606”, është përcaktuar qartë:

“Minimum dy (2) saldues të certifikuar sipas standardit ISO EN ISO 9606

Dëshmi të kërkuara:

– Certifikatat;

– Biografia (CV) e nënshkruar nga kandidati;

– Kontratë e punës (e përhershme ose për këtë kontratë), e nënshkruar nga të dy palët.”

Autoriteti Kontraktues ka eliminuar Operatorin Ekonomik “N&B” SH.P.K., me arsyetimin se CV-ja e njërit prej salduesve të ofruar – z. Lavdim Babaj – nuk ishte e nënshkruar nga vetë kandidati, duke konstatuar mungesën e një elementi formal të kërkuar në dokumentacionin e

tenderit.

Pas verifikimit të ofertës në platformën elektronike të prokurimit, eksperti shqyrtues konstaton se:

Është dorëzuar certifikata ISO EN ISO 9606 për z. Lavdim Babaj;

Është dorëzuar kontrata e punës e nënshkruar nga të dy palët;

Është dorëzuar edhe CV-ja përkatëse, mirëpo pa nënshkrimin e kandidatit, siç kërkohet shprehimisht në FDT.

Kjo mospërputhje paraqet një mangësi formale në dokumentacion, ndërkohë që përmbajtja e CV-së dhe dokumentet shoqëruese dëshmojnë për kualifikimin profesional dhe angazhimin e kandidatit.

Në këtë kontekst, mbetet për t'u vlerësuar nëse mungesa e nënshkrimit përbën devijim të vogël në kuptim të nenit 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Po ashtu, neni 59.2 i LPP-së parashikon mundësinë që Autoriteti Kontraktues të kërkojë sqarime për mospërputhje të kësaj natyre, nëse e vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

Në vijë me këtë, neni 45.30 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton se verifikimi i përshtatshmërisë dhe, nëse është e aplikueshme, i kualifikimeve të ofertuesit, mund të bëhet përmes Letrës standarde B45 "Kërkesë për sqarim të tenderit", përmes platformës elektronike. Ky mekanizëm ligjor ishte në dispozicion të AK-së për të kërkuar qartësimin e një dokumenti që përmban mangësi formale, por që nuk ndikon dukshëm në vlerësimin teknik të ofertës.

Megjithatë, mbetet në kompetencën e Autoritetit Kontraktues të vlerësojë nëse një mangësi e tillë, përkundër natyrës së saj formale, justifikon eliminimin, gjithmonë duke u bazuar në parimet e nenit 1, 6 dhe 7 të LPP-së, përkatësisht: trajtimin e barabartë, transparencën dhe përdorimin racional të fondeve publike.

Përfundimisht, nëse rrethana të ngjashme janë trajtuar ndryshe në raport me operatorë të tjerë, atëherë çështja kërkon analizë të kujdesshme për të vlerësuar koherencën dhe proporcionalitetin e vendimmarrjes, gjithnjë në funksion të një procesi të drejtë dhe të barabartë vlerësimi.

Pretendimi Ankimor Nr. 2 ndaj OE të rekomanduar për kontratë:

Ankuesi pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në DFT për pozitën e Menaxherit të Projektit, konkretisht:

Nuk janë dorëzuar certifikatat e kërkuara për Siguri dhe Shëndet në Punë dhe për Mbrojtje nga Zjarri, të cilat janë të detyrueshme sipas kërkesës së DFT-së për këtë pozitë.

CV-ja e personit të ofruar (Arben Mazreku) tregon angazhim të njëkohshëm në katër kompani të ndryshme, pa asnjë sqarim për statusin e tij si bashkëpunëtor i jashtëm, duke ngritur dyshime për angazhimin e tij real dhe ekskluziv për projektin në fjalë. Ankuesi thekson se ky person është gjithashtu drejtor i njërit nga OE-të pjesëmarrës, çka sipas tij duhet të ishte shqyrtuar më me kujdes nga

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 2

Në kuadër të këtij pretendimi, operatori ekonomik ankues kundërshton përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit nga ana e OE-së së rekomanduar për kontratë, duke u fokusuar në dy çështje kryesore:

A. Mungesa e certifikatave për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri për Menaxherin e Projektit

Sipas Dosjes së Tenderit (FDT), në seksionin "Kapaciteti Teknik dhe Profesional", konkretisht në pikën 2, është kërkuar:

"Një (1) Menaxher ku O.E. duhet të caktojë me vendim menaxherin e kontratës për këtë projekt – Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master në drejtimin konstruktiv, i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtje në punë."

Po ashtu, në listën e dokumenteve mbështetëse është specifikuar:

• Vendimin mbi emërimin e menaxherit të projektit;

• Diplomë universitare (kopje);

• Certifikatat;

• Biografia (CV) e nënshkruar nga kandidati;

• Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar për kandidatin e propozuar në këtë pozitë, z. Arben Mazreku, rezulton se në ofertë nuk janë të bashkëngjitura certifikatat që dëshmojnë përgatitjen e tij profesionale për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe për mbrojtje nga zjarri, siç kërkohet në mënyrë të qartë nga FDT.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar, pasi mungesa e këtyre certifikatave përbën mospërmbushje të kriterit të përcaktuar në dokumentacionin e tenderit.

B. Angazhimi i njëkohshëm i Menaxherit të Projektit në disa kompani

Ankuesi ka paraqitur si çështje të diskutueshme edhe faktin që kandidati i propozuar për Menaxher Projekti rezulton të jetë i angazhuar njëkohësisht në kompani të tjera, duke vënë në dyshim mundësinë reale të angazhimit të tij në këtë projekt.

Në lidhje me këtë çështje, eksperti vlerëson se, duke pasur parasysh rolin udhëheqës të Menaxherit të Projektit në zbatimin e kontratës, Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë sqarim shtesë lidhur me natyrën, kohëzgjatjen dhe përputhshmërinë e angazhimeve të tij të tjera, në mënyrë që të sigurohet se përmbushja e detyrave në këtë kontratë nuk do të cenohet.

Megjithatë, duhet theksuar se FDT nuk e ndalon shprehimisht që një individ të ketë marrëdhënie pune me palë të tjera, veçanërisht në rastin konkret kur kemi të bëjmë me kontratë kornizë, ku angazhimi i stafit mund të jetë periodik dhe jo i përditshëm.

Mbështetur në arsyet e lartcekura, eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi Ankimor Nr. 2 është pjesërisht i bazuar.

Mungesa e certifikatave për siguri dhe shëndet në punë si dhe për mbrojtje nga zjarri, për kandidatin e propozuar në pozitën e Menaxherit të Projektit, përbën mospërmbushje të qartë të një kriteri të përcaktuar në FDT dhe duhej të reflektohej në vlerësimin e ofertës.

Ndërkohë, për çështjen e angazhimit të shumëfishtë të këtij kandidati në kompani të tjera, nuk rezulton të ketë ndonjë ndalim të drejtpërdrejtë në DFT; megjithatë, Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë sqarime shtesë, në përputhje me nenin 59.2 të LPP-së, për të garantuar që angazhimi në këtë projekt të jetë real dhe i zbatueshëm praktikisht.

Në këto rrethana, rekomandohet që kjo çështje të shqyrtohet me kujdes në rivlerësim, në harmoni me kërkesat e dokumentacionit të tenderit dhe parimet e barazisë dhe proporcionalitetit të sanksionuara me nenin 7 dhe 6 të LPP-së.

Pretendimi Ankimor Nr. 3 ndaj OE të rekomanduar për kontratë:

Operatori Ekonomik ankues pretendon se, megjithëse Operatorit të shpallur fitues i është kërkuar sqarim për ofrimin e certifikatës sipas standardit ISO EN ISO 9606 për salduesit, dhe ky i fundit ka dorëzuar certifikatën për z. Clirim Binaku, i cili figuron edhe në listën e stafit të dorëzuar fillimisht nga GOE-ja, si dhe në ofertën fillestare janë përfshirë CV-ja dhe kontrata e punës për këtë saldues, CV-ja e ofruar nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Sipas ankuesit, dokumenti i quajtur CV nuk përmban të dhëna personale apo profesionale të plota, mungon përshkrimi i përvojës dhe vendi i lindjes nuk është i specifikuar siç kërkohet, duke mos përmbushur standardet minimale të një biografie. Për më tepër, CV-ja e ofruar është edhe në kundërshtim me nenin 69 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik dhe nuk lejohet sqraimi.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 3

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se dokumenti i paraqitur si “CV” për z. Çlirim Binaku nga ana e grupit të operatorëve ekonomikë të rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FDT), duke theksuar se mungojnë të dhënat personale dhe profesionale, përshkrimi i përvojës dhe të tjera informacione përbërëse të një biografie. Sipas ankuesit, një dokument i tillë nuk duhet të pranohet si CV valide.

Sipas dokumentacionit të tenderit, për pozitën “Saldues i certifikuar sipas standardit ISO EN ISO 9606”, në Kapacitetin Teknik dhe Profesional është kërkuar si më poshtë:

“Minimum dy (2) saldues të certifikuar sipas standardit ISO EN ISO 9606.

Dëshmi të kërkuara:

– Certifikatat;

– Biografia (CV) e nënshkruar nga kandidati;

– Kontrata e punës (e përhershme ose për këtë kontratë), e nënshkruar nga të dy palët.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë, rezulton se për z. Çlirim Binaku janë dorëzuar:

Certifikata përkatëse ISO EN ISO 9606;

Kontratë pune e nënshkruar nga të dy palët;

Dokument i titulluar si "CV", i cili është nënshkruar nga kandidati.

Dokumenti i quajtur CV, ndonëse i thjeshtë në përmbajtje, përmban emrin, mbiemrin, vendin e lindjes, përshkrim të aftësive salduese dhe sociale, si dhe trajnimet e ndjekura. Kjo përmbajtje nuk është e pasur me detaje të përvojës së punës, por duhet theksuar se FDT nuk ka kërkuar që salduesit të kenë përvojë pune të mëparshme, as nuk ka përcaktuar ndonjë format apo përmbajtje të detyrueshme të CV-së, përveçse ajo të jetë e nënshkruar nga kandidati, gjë që është përmbushur.

Në këtë drejtim, mungesa e përshkrimit të detajuar të përvojës nuk mund të cilësohet si mospërputhje me kërkesat e DT-së. Dokumenti i dorëzuar përmbush kërkesën formale për CV të nënshkruar dhe përmban elementë bazikë të një biografie, aq më tepër që nuk është përcaktuar ndonjë standard i saktë i përmbajtjes.

Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar, pasi dokumentacioni i dorëzuar për pozitën e salduesit është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në FDT, dhe Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë ndonjë shkelje ligjore apo procedurale duke pranuar këtë dokument si pjesë e vlefshme e ofertës.

Pretendimi Ankimor Nr. 4 ndaj OE të rekomanduar për kontratë:

Operatori Ekonomik ankues pretendon se GOE i shpallur fitues nuk ka përmbushur kërkesën e parashikuar në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit, përkatësisht nuk ka dëshmuar posedimin e disa prej pajisjeve të domosdoshme për realizimin e punimeve.

Në veçanti, ankuesi thekson se nga dokumentacioni i ofertës së dorëzuar nga GOE mungon dokumentacioni për pajisjet si më poshtë:

Cekani pneumatik (pozita 11 në Aneksin 8): GOE ka paraqitur një çekiç që përdoret në ekskavator, por pa dëshmi që të jetë pneumatik;

PaJisje përzierëse e betonit për ekskavator (pozita 12 në Aneksin 8): mungon plotësisht dëshmia për këtë pajisje;

Kamion kipper me peshë bartëse deri 5 ton (pozita 6 në Aneksin 8): kërkohen 2 njësi, ndërsa GOE ka ofruar vetëm një (1) kamion me marrëveshje për shfrytëzim.

Në këto rrethana, sipas pretendimit të ankuesit, GOE nuk ka plotësuar kërkesën e detyrueshme për pajisje në përputhje me Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit dhe për pasojë nuk është dashur të rekomandohet për kontratë.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 4

Operatori Ekonomik ankues ka kontestuar përmbushjen e kërkesave të Aneksit 8 të Dosjes së Tenderit nga ana e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, duke pretenduar se nuk janë dëshmuar disa nga pajisjet e kërkuara për realizimin e punimeve, përkatësisht: (i) çekiçi pneumatik, (ii) pajisja për përzierjen e betonit për ekskavator dhe (iii) kamioni kipper me kapacitet bartës ≤5 ton.

Sipas dokumentacionit të ofertës, konsorciumi i përbërë nga “BEREQETI-ING” SH.P.K. dhe “AAB CONSTRUCTION” SH.P.K. ka dorëzuar dy lista të ndara të pajisjeve, si dhe një marrëveshje për qira të mjeteve me kompaninë “NNT BINI” SH.P.K., shoqëruar me Aneksin 8 të nënshkruar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton sa vijon:

1. Çekiçi pneumatik (pozita 11)

Është paraqitur një dokument doganor për një çekiç që montohet në ekskavator, model Hammer Krupp HM 701-1/cp, por nuk jepet asnjë dëshmi që kjo pajisje është e llojit pneumatik, siç kërkohet. Megjithëse mungon verifikimi teknik, ekzistenca e modelit dhe dokumenti doganor paraqesin një bazë të arsyeshme që kjo çështje të mund të ishte objekt i sqarimit nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me nenin 59.2 të LPP-së.

2. Pajisje për përzierje betoni për ekskavator (pozita 12)

Në listë figurojnë dy përzierëse betoni me kapacitet 0.5 m³, por mungon çdo dokument teknik apo dëshmi që ndonjëra prej tyre është e përshtatshme për montim në ekskavator, siç kërkohet saktësisht në Aneksin 8. Gjithashtu mungon çdo dokument përcjellës. Në mungesë të çdo informacioni orientues, kjo çështje nuk ishte e mundur të sqarohej përmes nenit 59.2.

3. Kamion kipper me kapacitet bartës ≤5 ton (pozita 6)

Në listën e mjeteve figurojnë tre kamionë kipper (MAN 2006, Mercedes-Benz 2008 dhe 2009), si dhe një kamion kipper me kran (Volvo 1990), por nuk jepet asnjë dokument që të vërteton kapaicitetin bartës ≤5 ton.  Autoriteti Kontraktues ka pasur bazë të mjaftueshme për të kërkuar sqarim me dokumentacion mbështetës në përputhje me nenin 59.2 të LPP-së.

Mbështetur në arsyet e lartcekura, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i paraqitur është pjesërisht i bazuar.

Nga analiza e dokumentacionit dhe natyra e mungesave të identifikuara, konstatohet se Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi ligjore dhe praktike për të kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë, të paktën për pajisjet në pozitat 11 dhe 6, në përputhje me nenin 59.2 të Ligjit për Prokurimin Publik, me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë teknike të ofertës.

Rekomandohet që Autoriteti Kontraktues të shfrytëzojë të drejtën për sqarim sipas nenit 59.2 të LPP-së dhe të vijojë me rivlerësimin e ofertës, duke respektuar parimet e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë.

Pretendimi Ankimor Nr. 5 ndaj OE të rekomanduar për kontratë:

Operatori Ekonomik ankues pretendon se në Dosjen e Tenderit (DTF), Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që specifikimet teknike të jenë të detyrueshme sipas Aneksit 1. Sipas ankuesit, në ofertën e operatorit të rekomanduar për kontratë nuk figuron asnjë deklaratë e veçantë nga ana e këtij

operatori që ai do t'i respektojë specifikimet teknike. Ankuesi pretendon se në vend të kësaj, në ofertë është përfshirë një kopje e përshkrimit teknik të njëjtë me atë të dosjes së tenderit, e marrë përmes procesit "copy-paste", pa qenë e nënshkruar apo vulosur nga asnjëra palë e operatorit ekonomik të rekomanduar.

Në përmbyllje, ankuesi kërkon që, për shkak të mungesës së kësaj deklarate të nënshkruar dhe të vulosur, operatori i rekomanduar të eliminohet si i papërgjegjshëm dhe lënda të kthehet në rivlerësim, duke theksuar se vetëm operatori ekonomik "N&B SH.P.K." dhe "BM GROUP SH.P.K." kanë dorëzuar dokumentacion të plotë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 5:

Pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues, sipas të cilit në ofertën e operatorit të rekomanduar për kontratë mungon një deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur për respektimin e specifikimeve teknike, nuk qëndron.

Nga shqyrtimi i Dosjes së Tenderit rezulton se Autoriteti Kontraktues, në Aneksin 1 të FDT-së, ka përcaktuar që specifikimet teknike janë të detyrueshme, por nuk ka kërkuar që përshkrimi teknik të jetë i nënshkruar apo i vulosur nga ndonjëra palë e operatorit ekonomik.

Gjithashtu, rezulton se operatori i rekomanduar për kontratë ka ofruar një dokument të veçantë, të titulluar "Përshkrimi teknik i rrethojave", i cili përputhet me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Aneksin 1 të DTF-së. Ky dokument është dorëzuar si pjesë e ofertës dhe paraqet përmbajtje të qartë në lidhje me karakteristikat teknike të kërkuara për realizimin e pozicioneve përkatëse të kontratës.

Eksperti shqyrtues po ashtu sqaron se sipas nenit 3 të FDT-së, specifikimet teknike janë të detyrueshme dhe punët duhet të jenë në pajtim të plotë me Aneksin 1, përndryshe tenderi do të konsiderohet i papërgjegjshëm. Në këtë rast, operatori i rekomanduar ka ofruar dokumentin "Përshkrimi teknik i rrethojave", në përputhje të plotë me Aneksin 1 të FDT-së, përmbushur kështu kërkesën thelbësore për përputhshmëri përmbajtjesore, edhe pse nuk ka pasur kërkesë që ai të nënshkruhej ose vulosej.

Duke u mbështetur në vlerësimin e mësipërm, eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi i operatorit ankues nuk mbështetet në rrethanat konkrete të rastit.

Dokumenti i dorëzuar nga operatori i rekomanduar për kontratë përmban përshkrim të qartë teknik në përputhje me kërkesat e Aneksit 1 të DTF-së, ndërkohë që Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar si kusht që ky dokument të jetë i nënshkruar apo i vulosur.

Për rrjedhojë, nuk konstatohet mospërputhje që do të duhej të çonte në eliminimin e ofertës.

Pretendimi Ankimor Nr. 6 ndaj GOE "Muhamet Muqiqi, HARTS GROUP SHPK, VALDRINI SHPK":

Operatori Ekonomik ankues konteston përputhshmërinë e dokumentacionit të dorëzuar nga grupi i operatorëve ekonomikë "Muhamet Muqiqi, HARTS GROUP SHPK, VALDRINI SHPK", duke pretenduar se:

Përveç teknikëve të makinerive, nuk janë paraqitur kontrata të nënshkruara për pjesën tjetër të stafit profesional dhe teknik të kërkuar në FDT.

Lista e ATK-së është paraqitur, por nuk përbën provë për marrëdhënie kontraktuale konkrete, pasi nuk përmban të dhëna për kushtet e punës dhe angazhimin për projektin.

Kërkesa në FDT është e qartë: duhet dorëzuar kontratë pune e përhershme ose për këtë kontratë, e nënshkruar nga të dy palët.

Sipas nenit 59 të LPP-së, mungesa e kontratave të tilla përbën mangësi thelbësore dhe duhet të çojë në eliminim të ofertës.

Për rrjedhojë, ankuesi kërkon eliminimin e këtij GOE dhe ndërmarrjen e masave për rregullimin e trajtimit të barabartë në procedurë.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 6:

Operatori Ekonomik ankues ka kontestuar përputhshmërinë e dokumentacionit të dorëzuar nga grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë, duke theksuar se përveç teknikut të makinerive, për pjesën tjetër të stafit profesional dhe teknik të kërkuar në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FDT), nuk janë dorëzuar kontrata pune të nënshkruara nga të dy palët, ashtu siç është kërkuar qartazi në dokumentacionin e tenderit.

Sipas FDT-së, për pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të kapaciteteve teknike dhe profesionale (që përfshijnë pozitat si: mbikëqyrës i punimeve, drejtues i punimeve të ndërtimit, inxhinier i ndërtimtarisë, teknik i ndërtimtarisë, gjeodet, përgjegjës për siguri dhe shëndet në punë etj.), është kërkuar:

"Kontratë pune të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët."

Pas shqyrtimit të ofertës së grupit të OE-ve në platformën elektronike, eksperti shqyrtues konstaton se është dorëzuar kontratë pune vetëm për teknikun e makinerive, z. Agon Bytyqi. Për pjesën tjetër të stafit profesional dhe teknik nuk janë prezantuar kontrata të punës të nënshkruara nga të dy palët, sipas kërkesës së qartë të FDT-së. Janë dorëzuar dokumente të tjera si lista nga ATK, por këto nuk përmbajnë dëshmi të mjaftueshme për përfshirjen e tyre në projektin konkret dhe nuk përbëjnë provë të një marrëdhënieje kontraktuale.

Megjithatë, eksperti shqyrtues vëren se kjo çështje nuk është adresuar fare nga Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertës, dhe si e tillë përbën një element të paanalizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Prandaj, në pajtim me nenin 59.2 dhe nenin 72.3 të Ligjit për Prokurimin Publik, kjo çështje kërkon analizë të kujdesshme gjatë rivlerësimit, për të vlerësuar nëse mungesa e kontratave për pjesën tjetër të stafit mund të sqarohet në mënyrë të vlefshme në bazë të dokumenteve të dorëzuara, apo nëse përbën mangësi thelbësore që ndikon në përputhshmërinë me kërkesat e DT-së.

Për rrjedhojë, kjo çështje duhet të analizohet me kujdes nga komisioni i rivlerësimit, duke u bazuar në të gjitha dokumentet e ofertës dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe parimet e barazisë dhe transparencës në prokurim.

Pretendimi Ankimor Nr. 7 ndaj GOE "AGRO INVEST" SHPK, Rexha, Multi Business Group SHPK":

Operatori Ekonomik ankues pretendon se grupi i operatorëve ekonomikë “AGRO INVEST” SHPK, Rexha, Multi Business Group SHPK” nuk ka përmbushur kriterin e kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit lidhur me dëshminë për kontrata të ngjashme.

Sipas pretendimit, kërkesa ka qenë që operatori ekonomik të dëshmojë se ka realizuar me sukses kontrata të ngjashme me vlerë minimale prej 780,000.00 €, gjatë tre viteve të fundit, duke përdorur formatin e Aneksit 6 të DT-së dhe duke përfshirë të dhëna të detajuara si: titulli i kontratës, shuma, data e fillimit dhe përfundimit, përfituesi, referenca ose pranimet teknike.

Ankuesi thekson se operatori ekonomik i rekomanduar ka paraqitur një kontratë me vlerë 187,000.00 €, e cila është shumë më e ulët se vlera minimale e kërkuar dhe nuk përmbush kriterin thelbësor. Po ashtu, kontratat e tjera të dorëzuara nuk kanë të bëjnë me natyrën apo ngjashmërinë e punëve të kërkuara, për shkak se nuk korrespondojnë në përmbajtje me referencat apo nuk janë në përputhje me Udhëzuesin për Prokurimin Publik (NR. 002/2024 dhe NR. 001/2023).

Për këto arsye, ankuesi vlerëson se tenderi i këtij operatori është dashur të refuzohet si i papërgjegjshëm, bazuar në nenin 69 të LPP-së, për shkak të mosplotësimit të kritereve të vendosura në Njoftim dhe në DT.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 7:

Pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues, sipas të cilit grupi i operatorëve ekonomikë “AGRO INVEST” SHPK, Rexha, Multi Business Group SHPK” nuk ka përmbushur kriterin për kontrata të ngjashme me vlerë minimale 780,000.00 €, nuk qëndron.

Nga shqyrtimi i Dosjes së Tenderit rezulton se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

“1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme me vlerë minimale prej 780,000.00€ Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).

Një listë të kontratave të realizuara duke përdorur Aneksin 6 në DT-së, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën, datën e fillimit, datën e përfundimit të kontratës, përfituesin, si dhe listës t’i bashkëngjiten referencat ose pranimet teknike për kryerjen e punëve në lëmin e kërkuar apo të ngjashme, për 3 (tre) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e shërbimeve (Kontrata dhe Referencat duhet të korrespondojnë me njëra-tjetrën).”

Pra, siç del qartë nga kërkesa, Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar kontrata identike, por kontrata të ngjashme, në vlerë të përgjithshme mbi 780,000.00 €, të realizuara në 3 vitet e fundit, dhe të shoqëruara me referenca përkatëse.

Bazuar në analizën e dokumentacionit të dorëzuar dhe përmbajtjes së kërkesës së Autoritetit Kontraktues në DTF, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i paraqitur nuk gjen mbështetje.

Grupi i operatorëve ekonomikë të rekomanduar ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në formën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë kontrata të ngjashme me natyrën e aktivitetit dhe vlerë të përgjithshme që tejkalon pragun minimal prej 780,000.00 €, të shoqëruara me referenca mbështetëse.

Për rrjedhojë, nuk konstatohet ndonjë mospërputhje që do të çonte në diskualifikim të ofertës, dhe pretendimi i OE ankues vlerësohet si i pabazuar.

Pretendimi Ankimor Nr. 8 ndaj GOE VIA EGNATIA SH.P.K.; ALL ZONE SH.P.K.; INFRASTRUKTURA SH.P.K.

Operatori Ekonomik ankues, duke u mbështetur në vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës së grupit "VIA EGNATIA SH.P.K.; ALL ZONE SH.P.K.; INFRASTRUKTURA SH.P.K.", pretendon se ky grup nuk duhet të konsiderohet palë me interes, pasi:

Nuk ka ofruar kontrata dhe referenca që përmbushin kërkesën për vlerë minimale prej 780,000.00 € në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë;

Natyra e kontratave të dorëzuara nga ky grup – që përfshijnë pastrim lumenjsh dhe mirëmbajtje rrugësh – sipas ankuesit, nuk e përmbush kriterin e ngjashmërisë me objektin e kontratës, edhe pse vetë i konsideron ato si funksionalisht të krahasueshme;

Për të mbështetur këtë interpretim, ankuesi i referohet Udhëzuesve nr. 002/2024 dhe 001/2023 për Prokurimin Publik.

Këto pika përbëjnë po ashtu arsyet zyrtare të eliminimit të këtij grupi operatorësh nga Autoriteti Kontraktues, të cilave OE ankues u referohet në përkrahje të pozicionit të tij.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 8:

Pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues lidhet me përmbushjen e kërkesës për kontrata të ngjashme me vlerë minimale 780,000.00 €, nga ana e grupit "VIA EGNATIA SH.P.K.; ALL ZONE SH.P.K.; INFRASTRUKTURA SH.P.K.".

Nga shqyrtimi i ofertës rezulton se janë dorëzuar kontrata që përfshijnë punë për mirëmbajtje rrugësh dhe pastrim lumenjsh. Këto përmbajnë komponentë të ngjashëm me disa nga pozicionet e kontratës në këtë aktivitet prokurimi. Meqenëse dokumentet e tenderit nuk kanë paraparë përkufizim të hollësishëm për "ngjashmërinë", vlerësimi i këtyre kontratave do të duhej të bazohej në funksionalitetin dhe përmbajtjen e tyre reale.

Në rrethana të tilla, do të ishte e udhës që Autoriteti Kontraktues të kërkonte sqarime shtesë mbi natyrën e kontratave të paraqitura, në përputhje me nenin 59.2 të LPP-së dhe parimet e qartësimit të dokumenteve të ofertës të përcaktuara në nenet 40.12 dhe 40.13 të Rregullores për Prokurim Publik.

Duke marrë parasysh elementet e përfshira në kontratat e dorëzuara dhe mundësinë për sqarim të mëtejshëm përmes procedurës së paraparë në LPP, eksperti shqyrtues vlerëson se vendimmarrja për eliminim nuk është mbështetur në një analizë të plotë. Për rrjedhojë, pretendimi i paraqitur në këtë rast nuk gjen mbështetje, pasi vendimi i eliminimit nuk është vlerësuar si i ligjshëm në procedurë të mëparshme.

Vërejtje shtesë:

Sa i përket referencës ndaj OE DARNDANIA SHPK në tekstin e ankesës, vërehet se vetë operatori ankues e ka konsideruar këtë operator si palë pa interes, meqenëse është eliminuar nga

Autoriteti Kontraktues për mosplotësim të kritereve thelbësore. Për rrjedhojë, nuk është ngritur ndonjë pretendim i veçantë për ofertën e këtij operatori dhe nuk kërkohet trajtim i mëtejshëm në këtë analizë.

Pretendimi Ankimor Nr. 9 – lidhur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik ankues ka paraqitur pretendimin se vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të ofertës së tij është bërë me synim për ta eliminuar atë me çdo kusht dhe pa u trajtuar në mënyrë të drejtë. Sipas ankuesit:

AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim vetëm me formulimin "refuzohet", pa e sqaruar nëse arsyeja ishte mungesa e bazës, mosrespektimi i afatit apo ndonjë çështje tjetër ligjore;

Ky veprim konsiderohet nga ankuesi si në kundërshtim me nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 002/2024;

Ankuesi thekson se AK nuk ka trajtuar pretendimet ankimore të paraqitura brenda kërkesës për rishqyrtim, sidomos në raport me trajtimin e operatorëve të tjerë në procedurë, dhe e konsideron këtë si një shmangie të qëllimshme të vendimmarrjes së drejtë;

Sipas tyre, mungesa e përgjigjes së argumentuar nga ana e AK-së e bën këtë vendim të njëanshëm dhe të paarsyetuar, duke përmendur gjithashtu edhe nenin 108A të LPP-së, që kërkon arsyetim të vendimeve të tilla.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 9

Operatori Ekonomik ankues ka ngritur çështje në lidhje me mënyrën e trajtimit të kërkesës së tij për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues, duke theksuar mungesën e një arsyetimi të qartë dhe të detajuar për vendimin e refuzimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se vendimi për refuzimin e kërkesës është komunikuar në formë të shkurtër përmes platformës elektronike, pa një elaborim mbi bazën ligjore apo faktike të vlerësimit të kërkesës. Ndonëse ligji (neni 108/A, paragrafi 10.1 i LPP-së) lejon refuzimin e kërkesës për rishqyrtim kur ajo konsiderohet e pabazuar, megjithatë kjo duhet të bëhet në mënyrë të argumentuar, në respektim të parimeve të transparencës dhe të drejtës për informim dhe në pajtim me paragrafin 9 të nenit 108/A.

Në mungesë të një arsyetimi të qartë dhe të mbështetur në dokumentacion, eksperti shqyrtues vlerëson se mënyra e trajtimit të kërkesës për rishqyrtim nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në legjislacionin përkatës. Rekomandohet që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë këtë aspekt në mënyrë të plotë dhe të argumentuar, duke ofruar një përgjigje të qartë dhe të dokumentuar ndaj pretendimeve të parashtruara.

PËRFUNDIM

Pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura nga operatori ekonomik ankues dhe analizës së dokumentacionit të tenderit, eksperti shqyrtues vlerëson se disa nga çështjet e ngritura meritojnë vëmendje shtesë, veçanërisht në raport me mënyrën e zbatimit të kritereve të kualifikimit të përcaktuara në Formularin e të Dhënave të Tenderit (FDT) dhe me përputhshmërinë e dokumenteve të ofertës ndaj këtyre kërkesave.

Në disa raste është evidentuar nevoja për interpretim më të kujdesshëm të këtyre kritereve dhe për një trajtim më të balancuar të të gjitha ofertave, në frymën e parimeve të barazisë, transparencës dhe konkurrencës, të përcaktuara në nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Po ashtu, është vërejtur se në disa situata nuk është përdorur mundësia për kërkime sqarimesh shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72.3 të LPP-së dhe neneve 40.12 dhe 40.13 të Rregullores për Prokurim Publik, për çështje që potencialisht mund të ishin adresuar pa ndikuar në përmbajtjen thelbësore të ofertës.

Në këtë kontekst, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim, në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe dispozitat përkatëse të Rregullores për Prokurim Publik, duke garantuar që të gjitha ofertat të trajtohen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe në përputhje të plotë me dokumentacionin e tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Muhamet Muçiqi" Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0661 ka vlerësuar se:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Ankesa është paraqitur nga grupi i operatorëve ekonomikë "Muhamet Muçiqi; HARST Group SH.P.K.; Valdrini SH.P.K." kundër vendimit të Komunës së Prishtinës për eliminimin nga gara dhe rekomandimin për kontratë të një operatori tjetër në aktivitetin për "Ndërtimin e rrethojave të varrezave". Ankuesi pretendon se eliminimi i tij është bërë në mënyrë të pabazuar, vetëm për mungesë nënshkrimi në CV-në e një teknik-u, pa kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 52.7 të LPP-së. Ndërkohë, sipas ankesës, operatori i shpallur fitues nuk ka përmbushur disa nga kriteret kyçe të dosjes së tenderit – përfshirë kontratat e ngjashme, certifikatat profesionale, dëshmitë për pajisje dhe kualifikimet e stafit teknik.

Ankuesi gjithashtu thekson se çmimi i ofruar nga OE i rekomanduar është më i lartë dhe bie ndesh me parimin e "vlerës për para". Sipas tij, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë të pabarabartë dhe në kundërshtim me nenet 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së. Ai kërkon anulimin e vendimit dhe rivlerësimin e ofertave në pajtim me ligjin dhe dokumentacionin e tenderit.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUE

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të paraqitura nga operatorët ekonomikë "HARST GROUP SH.P.K.; Valdrini SH.P.K." dhe "Muhamet Muçiqi SH.P.K." kundër Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës, në lidhje me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës". Pas shqyrtimit të ankesës me nr. 2025/0661, dokumenteve të dorëzuara nga palët dhe të dhënave në platformën e prokurimit elektronik, eksperti shqyrtues paraqet analizën dhe vlerësimet në vijim:

Pretendimi Ankimor Nr. 1:

Operatori ekonomik ankues konteston vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin nga procedura e prokurimit, me arsyetimin se CV-ja e teknik-ut të makinerisë (Agon Bytyqi) nuk ishte nënshkruar. Ankuesi vlerëson se dokumentacioni i dorëzuar përmban të gjitha elementet thelbësore të kërkuara në Dosjen e Tenderit – diplomë, certifikatë, kontratë pune – dhe se mungesa e nënshkrimit në CV është një devijim formal që nuk cenon përmbajtjen apo

Ankuesi pretendon gjithashtu se vendimi për eliminim është bërë në kundërshtim me nenet 1, 2, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së, duke theksuar se vlerësimi është zgjatur në mënyrë të pajustifikuar për 73 ditë nga data e hapjes së ofertave dhe se arsyetimi i eliminimit është ndryshuar në mënyrë të pasqaruar. SIpas ankuesit ata jane eliminiuar dhe diskrimnuar padrejrtessiht me te vendim qellim qe te shperblejne sit e pergjegjshem GOE te tyre te preferuar e te cilet po ahstu ajne te papergjegjshem.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 1

Kërkesa në DT

Sipas pikës 6 të Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit, për pozitën "Një (1) teknik të makinerisë, i trajnuar për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri", kërkohen këto dokumente:

• Diplomë (kopje);

• Certifikatat për trajnim në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri;

• Biografi (CV) e nënshkruar nga kandidati;

• Kontratë pune e përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, e nënshkruar nga të dy palët.

Eksperti shyqrtues ka gjetur se Autoriteti Kontraktues ka eliminuar OE-në me arsyetimin se CV-ja e teknik-ut të makinerisë, z. Agon Bytyqi, nuk ishte e nënshkruar, duke konstatuar se kjo përbën mospërmbushje të njërit prej dokumenteve të kërkuara në mënyrë eksplicite në Dosjen e Tenderit.

Nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar për z. Agon Bytyqi, rezulton si vijon:

• Diploma është e noterizuar dhe në përputhje me kërkesën;

• Certifikatat për trajnim në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri janë të noterizuara dhe të lëshuara nga subjekt i licencuar (HSK LLC);

• Marrëveshja për shërbime është nënshkruar nga të dy palët dhe është lidhur për këtë aktivitet prokurimi;

• Është dorëzuar edhe CV-ja përkatëse, mirëpo CV-ja nuk përmban nënshkrimin e kandidatit, siç kërkohet në mënyrë të shprehur në dokumentacionin e tenderit.

Kjo mospërputhje paraqet një mangësi formale në dokumentacion, ndërkohë që përmbajtja e CV-së dhe dokumentet shoqëruese dëshmojnë për kualifikimin profesional dhe angazhimin e kandidatit.

Në këtë kontekst, mbetet për t'u vlerësuar nëse mungesa e nënshkrimit përbën devijim të vogël në kuptim të nenit 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Po ashtu, neni 59.2 i LPP-së parashikon mundësinë që Autoriteti Kontraktues të kërkojë sqarime për mospërputhje të kësaj natyre, nëse e vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

Në vijë me këtë, neni 45.30 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton se verifikimi i përshtatshmërisë dhe, nëse është e aplikueshme, i kualifikimeve të ofertuesit, mund të bëhet përmes Letrës standarde B45 "Kërkesë për sqarim të tenderit", përmes platformës elektronike. Ky mekanizëm ligjor ishte në dispozicion të AK-së për të kërkuar qartësimin e një dokumenti që përmban mangësi formale, por që nuk ndikon dukshëm në vlerësimin teknik të ofertës.

Megjithatë, mbetet në kompetencën e Autoritetit Kontraktues të vlerësojë nëse një mangësi e tillë, përkundër natyrës së saj formale, justifikon eliminimin, gjithmonë duke u bazuar në parimet e nenit 1, 6 dhe 7 të LPP-së, përkatësisht: trajtimin e barabartë, transparencën dhe përdorimin racional të fondeve publike.

Përfundimisht, nëse rrethana të ngjashme janë trajtuar ndryshe në raport me operatorë të tjerë, atëherë çështja kërkon analizë të kujdesshme për të vlerësuar koherencën dhe proporcionalitetin e vendimmarrjes, gjithnjë në funksion të një procesi të drejtë dhe të barabartë vlerësimi. .

Pretendimi Ankimor Nr. 2 (kundër GOE të rekomanduar për kontratë)

Operatorët ekonomikë ankues pretendojnë se grupi i operatorëve "BEREQETI – ING; AAB Construction SH.P.K." nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 9.1 dhe 9.2 të FDT-së lidhur me dëshminë për përvojë të ngjashme. Sipas tyre, OE i rekomanduar ka dështuar të ofrojë lista të kontratave të përfunduara me sukses me vlerë minimale prej 780,000.00 euro në tre vitet e fundit, të cilat duhet të jenë të ngjashme në natyrë dhe objekt me kontratën në fjalë.

Ankuesit theksojnë se një pjesë e madhe e kontratave të dorëzuara nga lideri i grupit "BEREQETI ING" dhe anëtari tjetër "AAB Construction" nuk janë të ngjashme në natyrë (shumica janë për mirëmbajtje, furnizime, ose për asfaltim), ndërsa disa nuk janë të shoqëruara me referenca për kryerjen e punëve apo përfundojnë jashtë afatit të lejuar 3-vjeçar. Po ashtu, në disa raste mungojnë dokumentet përcjellëse si: listat e punëve, procesverbalet e pranimit teknik, ose kontratat nuk janë të detajuara për të mundësuar vlerësim të qartë nëse janë të krahasueshme me kontratën objekt të këtij tenderi.

Për këtë arsye, ankuesit konsiderojnë se operatori i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kriterin e përvojës së ngjashme, duke bërë që oferta e tij të jetë e papërgjegjshme. Ata argumentojnë se AK është dashur ta eliminojë këtë ofertë në përputhje me nenet 59 dhe 60 të LPP-së, si dhe me kërkesat specifike të FDT-së dhe NJK-së për dëshminë e kontratave të ngjashme.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 2

Pretendimi i Operatorëve Ekonomikë ankues, sipas të cilëve grupi i operatorëve "BEREQETI – ING; AAB Construction SH.P.K." nuk ka përmbushur kriterin për kontrata të ngjashme me vlerë minimale 780,000.00 €, vlerësohet si i pabazuar.

Së pari, nga analiza e Dosjes së Tenderit rezulton se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që OE-të të dëshmojnë:

"Kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, me vlerë të përgjithshme mbi 780,000.00 € në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, të shoqëruara me listën përkatëse dhe dokumentet mbështetëse si kontrata, referenca apo procesverbale pranimi."

Kërkesa e AK-së nuk është kufizuar në kontrata identike, por është formuluar mbi kriterin “të ngjashme”, çka nënkupton një fleksibilitet të arsyeshëm në vlerësim brenda periudhës kohore të specifikuar, dhe të shoqëruara me dokumentacion mbështetës përkatës (referenca ose procesverbale të pranimit teknik).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në ofertën e grupit “BEREQETI – ING; AAB Construction SH.P.K.” rezulton se është paraqitur lista e kontratave të realizuara, e plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara sipas Aneksit 6 të DT-së, si dhe me referencat përkatëse për punët e kryera. Vlerat e kontratave dhe natyra e tyre përputhen me kërkesat e FDT-së, duke dëshmuar realizimin e kontratave të ngjashme me vlerë mbi pragun e kërkuar prej 780,000.00 €.

Nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se janë paraqitur kontrata të natyrës së ngjashme dhe të shoqëruara me dokumentacion mbështetës. Në këto rrethana, pretendimi nuk gjen mbështetje të mjaftueshme faktike për të konstatuar mospërputhje me kërkesat e përcaktuara në DT.

Pretendimi Ankimor Nr. 3 (kundër GOE të rekomanduar për kontratë)

Operatorët ekonomikë ankues kontestojnë përputhshmërinë e stafit teknik të ofruar nga GOE i rekomanduar “BEREQETI ING; AAB Construction SH.P.K.”, konkretisht për pozicionin e Menaxherit të kontratës për projektin – inxhinier konstruktiv me certifikata për siguri dhe mbrojtje nga zjarri dhe në punë.

Sipas kërkesës së FDT-së, menaxheri duhet të jetë i diplomuar në inxhinieri ndërtimi (ose master në të njëjtin drejtim) dhe të posedojë certifikata të vlefshme për sigurinë në punë dhe mbrojtjen nga zjarri. Sidoqoftë, lideri i grupit ofertues ka ofruar z. Arben Mazrekun, për të cilin nuk është dorëzuar dëshmi për këto certifikata (as për siguri në punë, as për mbrojtje nga zjarri), dhe as nënshkrim i CV-së apo kontratë e përhershme pune. Ankuesi argumenton se këto mungesa janë thelbësore dhe përbëjnë bazë për eliminim sipas nenit 59 dhe 60 të LPP-së.

Po ashtu, vërehet se për këtë rast Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar sqarime, ndonëse në raste të tjera për mungesa më të vogla ka kërkuar informata shtesë nga operatorët e tjerë. Ankuesi e sheh këtë si trajtimi i pabarabartë dhe diskriminues, duke theksuar se eliminimi është aplikuar vetëm ndaj tyre për mungesë të një nënshkrimi në CV, ndërsa ndaj GOE të rekomanduar është toleruar mungesa e dokumenteve thelbësore.

Për rrjedhojë, kërkohet që edhe GOE i rekomanduar të eliminohet si ofertë e papërgjegjshme, në përputhje me kriteret e FDT-së dhe nenet përkatëse të LPP-së.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 3

Sipas Dosjes së Tenderit (Fletës së të Dhënave të Tenderit - FDT), në seksionin “Kapaciteti Teknik dhe Profesional”, pikës 2, është kërkuar që:

“Një (1) Menaxher, i cili duhet të caktohet me vendim për këtë projekt, të jetë inxhinier i diplomuar në ndërtimtari ose master në drejtimin konstruktiv, i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, si dhe për mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtje në punë.”

Gjithashtu, në listën e dokumenteve mbështetëse të kërkuara janë përfshirë:

Vendimi për emërimin e menaxherit të projektit;

Kopje e diplomës universitare;

Certifikatat përkatëse;

CV-ja e nënshkruar nga kandidati;

Kontrata e punës (e përhershme ose për këtë kontratë), e nënshkruar nga të dy palët.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga GOE i rekomanduar për kandidatin e propozuar, z. Arben Mazreku, rezulton se nuk janë bashkëngjitur certifikatat që dëshmojnë përgatitjen profesionale në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe për mbrojtje nga zjarri, të cilat janë kërkuar qartë në FDT.

Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim është i bazuar, pasi mungesa e këtyre certifikatave përbën mosplotësim të kriterit të përcaktuar në dokumentacionin e tenderit.

Pretendimi Ankimor Nr. 4 (kundër GOE të rekomanduar për kontratë)

Operatori Ekonomik ankues pretendon se GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar si teknik të makinerisë dy (2) Inxhinier të Makinerisë, duke shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, konkretisht nenin 5, 59 dhe 60 të LPP-së, për faktin se sipas ankuesit ky grup nuk ka arritur të dëshmojë se ka përmbushur kërkesat teknike dhe profesionale të përcaktuara në nenin 9.1 dhe 9.2 të FDT-së, që kërkon:

Një (1) teknik të makinerisë, i trajnuar për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri.

• Diplomë (kopje);

• Certifikata për trajnim;

• Biografia (CV) e nënshkruar nga kandidati;

• Kontratë pune e përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, e nënshkruar nga të dy palët.

Ankuesi thekson se nga analiza e dokumentacionit të ofertës së GOE-së të rekomanduar rezulton se:

Është prezantuar z. Jeton Gashi, Master i Shkencave në Inxhinieri Makinerike, të cilit i mungon Certifikata për siguri dhe shëndet në punë si dhe Certifikata për mbrojtje nga zjarri, dhe për rrjedhojë, sipas ankuesit, nuk e plotëson kërkesën për teknik të makinerisë siç është përcaktuar në FDT.

Po ashtu, është prezantuar z. Armrush Berbatovci, Inxhinier me diplomë në makineri, për të cilin është paraqitur një vërtetim i KEK-ut për trajnim të mbajtur në vitin 2006 me temë "Siguria Industriale dhe mbrojtja nga zjarri", mirëpo sipas ankuesit ky vërtetim nuk zëvendëson kërkesën për certifikatë të vlefshme dhe aktuale në përputhje me Dosjen e Tenderit.

Sipas ankuesit, asnjëri nga dy të prezantuarit nuk përmbush kërkesën për "Certifikatë për siguri dhe shëndet në punë dhe për mbrojtje nga zjarri", dhe rrjedhimisht GOE i shpallur fitues nuk e ka plotësuar kriterin teknik të kërkuar për këtë pozitë.

Në përmbyllje, ankuesi pretendon se moseliminimi i këtij GOE përbën shkelje të dispozitave të LPP-së, favorizim dhe trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë, duke theksuar se operatorë të tjerë janë eliminuar për mangësi të ngjashme, ndërsa këtij grupi i është lejuar të vazhdojë në procedurë pa përmbushur kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 4

Kërkesa në Dosjen e Tenderit (FDT):

Sipas pikës 6 të Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit, për pozitën "Një (1) teknik të makinerisë, i trajnuar për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri", kërkohen dokumentet e mëposhtme mbështetëse:

Diplomë (kopje);

Certifikata për trajnim në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri;

Biografi (CV) e nënshkruar nga kandidati;

Kontratë pune e përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, e nënshkruar nga të dy palët.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga GOE i rekomanduar për kontratë, në listën e punëtorëve të paraqitur nga grupi i operatorëve "BEREQETI ING; AAB Construction SH.P.K.", rezulton se janë propozuar për pozitat përkatëse:

Nr.Emri Mbiemri Pozita në listë

2Jeton Gashi Inxhinier Makinerie

4Armrush Berbatovci Teknik dhe Inxhinier Makinerie

Pra, sipas listës zyrtare të stafit të dorëzuar, për pozitën e teknikut të makinerisë është propozuar vetëm z. Armrush Berbatovci, ndërsa z. Jeton Gashi është propozuar për pozitën e inxhinierit të makinerisë, që ka kërkesa të tjera në FDT dhe nuk lidhet me pozitën e teknikut.

Për pozitën e inxhinierit të makinerisë (pikë tjetër në FDT), nuk kërkohet trajnim për siguri dhe mbrojtje nga zjarri, dhe për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit se janë ofruar "dy teknikë" për këtë pozitë nuk është i saktë.

Eksperti shqyrtues sqraon se Z. Armrush Berbatovci është i vetmi kandidat i paraqitur për pozitën e teknikut të makinerisë, për të cilin janë dorëzuar: diplomë universitare në Inxhinieri Makinerie, CV e nënshkruar, kontratë pune e nënshkruar nga të dy palët, si dhe një vërtetim i lëshuar nga KEK sh.a., datë 18.04.2025, ku konfirmohet se kandidati ka përfunduar me sukses trajnimin me temën "Siguria industriale dhe mbrojtja nga zjarri" më datë 08.06.2006. Ky dokument është i nënshkruar dhe i vulosur zyrtarisht, dhe përmban tematikë përputhëse me kërkesën e FDT-së, mirëpo nuk është i titulluar si "certifikatë trajnimi", siç kërkohet në mënyrë eksplicite në dokumentacionin e tenderit. Gjithashtu, trajnimi i përmendur është kryer para 19 viteve dhe nuk përmban të dhëna shtesë mbi përmbajtjen e programit, kohëzgjatjen apo vlefshmërinë aktuale të tij.

Dokumenti i dorëzuar përmban elementë përmbajtësorë që përputhen me qëllimin e kërkesës së FDT-së, por për shkak të formës së tij si "vërtetim" dhe jo "certifikatë", paraqet një mospërputhje formale, për të cilën Autoriteti Kontraktues duhet të vlerësojë nëse përbën devijim të papranueshëm apo mangësi që mund të sqarohej. Në këtë kontekst, mbetet në diskrecionin e AK-së të vendosë nëse dokumenti i dorëzuar përmbush kërkesën e DT-së, duke u bazuar në parimet e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë, si dhe në mundësinë që ofron neni 59.2 i LPP-së dhe neni 45.30 i Rregullores për Prokurimin Publik, përmes përdorimit të Letrës standarde B45 për kërkesë për sqarim.

Sipas ekspertit shqyrtues pretendimi i operatorit ankues se janë ofruar "dy teknikë të makinerisë" nuk është faktikisht i saktë, pasi nga lista e personelit e dorëzuar nga GOE i shpallur fitues rezulton qartë se vetëm z. Armrush Berbatovci është propozuar për këtë pozitë, ndërsa z. Jeton Gashi është paraqitur për pozitën e inxhinierit të makinerisë – pozitë tjetër për të cilën nuk kërkohet certifikatë trajnimi për siguri dhe mbrojtje nga zjarri. Në këto rrethana, dokumenti i dorëzuar për z. Berbatovci është përmbajtësisht përputhës me temën e kërkuar, por jo në formën e specifikuar në DT, ndaj paraqet një mospërputhje që kërkon një vlerësim të kujdesshëm nga Autoriteti Kontraktues, duke garantuar që vendimmarrja të jetë në përputhje me parimet e nenit 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së. Nëse raste të ngjashme janë trajtuar ndryshe, atëherë një rishyrtim i barabartë do të jetë i nevojshëm për të ruajtur koherencën dhe besueshmërinë e procesit të vlerësimit.

Pretendimi Ankimor Nr. 5 (kundër GOE të rekomanduar për kontratë

Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbushur disa nga kërkesat themelore të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe se për pasojë është dashur të eliminohet nga gara. Konkretisht, sipas Ankuesit:

I. Mungesa e pajisjeve të kërkuara sipas Aneksit 8 të FDT-së

OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar se posedon pajisjet e kërkuara në Aneksin 8 të FDT-së, të cilat ishin të domosdoshme për realizimin e kontratës. Nga analiza e dokumentacionit, mungojnë dëshmi të qarta për këto pajisje:

Kamionët për bartjen e mbeturinave (1 copë)

Pajisje për zëvendësimin e betonit për eskavator (1 copë)

Kamion kipper me peshë bartëse deri 5 ton (1 copë)

Çekan pneumatik (1 copë)

Aparaturë CNC ose teknologji e ngjashme (1 copë)

Makineri punuese (damper) 3 deri në 5 ton (1 copë)

Pretendimi thekson se OE i shpallur fitues nuk ka dorëzuar dëshmi konkrete për këto pajisje, qoftë në formën e kontratave të qirasë, certifikatave të pronësisë apo dokumenteve të tjera përkatëse, çka e bën ofertën e tij të papërgjegjshme

II. Çmime të jashtëzakonshme – tejkalim i nivelit të tregut

Gjithashtu, pretendohet se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime që tejkalojnë ndjeshëm çmimet e tregut për disa pozicione, duke e bërë të pabesueshme përmbajtjen financiare të ofertës. Ankuesi thekson se:

Komisioni i vlerësimit nuk ka hulumtuar apo analizuar fare tregun për të justifikuar këto çmime.

Janë ofruar çmime ekstreme në raport me parashikimin buxhetor, por nuk ka pasur asnjë sqarim apo krahasim me çmime të tregut real.

Nuk janë ndërmarrë hapa për të verifikuar nëse këto çmime janë të arsyeshme në raport me produktet dhe shërbimet e ofruara, siç paarshihet në nenin 4 të RrPP-së.

Kjo, sipas Ankuesit, përbën shkelje të detyrimeve të Autoritetit Kontraktues dhe Komisionit të Vlerësimit për të verifikuar arsyeshmërinë e ofertave financiare dhe për të siguruar përdorim racional të mjeteve publike

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 5

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së Grupit të Operatorëve Ekonomikë "BEREQETI – ING" SH.P.K. & "AAB CONSTRUCTION" SH.P.K., vlerësimi për secilën nga pajisjet e listuara në Aneksin 8 të FDT-së është si vijon:

1.Kamion për bartjen e mbeturinave (1 copë)

Në vend të kamionit të kërkuar, OE ka paraqitur një kamionetë dubelkabinë, të shoqëruar me fotografi, por pa asnjë dëshmi funksionale që vërteton përshtatshmërinë për bartjen e mbeturinave (si p.sh. kontenier, sistem ngritës ose trup të dedikuar). Kërkesa e FDT-së nuk rezulton të jetë përmbushur

2.Pajisje për zëvendësimin e betonit për ekskavator (1 copë)

OE ka paraqitur dy përzierëse betoni me kapacitet 0.5 m³, por pa specifikim se janë të montueshme në ekskavator apo të përshtatshme për funksionin e kërkuar. Kërkesa nuk është dëshmuar.

3.Kamion kipper me peshë bartëse deri 5 ton (2 copë)

OE ka paraqitur disa kamionë kipper, por dokumentacioni nuk përmban të dhëna të sakta për kapacitetin e tyre bartës. Mungesa e specifikimeve teknike e bën të pamundur verifikimin e përputhshmërisë me kërkesën.

4.Çekan pneumatik (1 copë)

Dokumentacioni përfshin një çekiç për ekskavator, por pa katalog teknik, certifikatë apo përshkrim të tipit të tij, duke e lënë të paqartë nëse bëhet fjalë për pajisje pneumatik. Kërkesa nuk është dëshmuar në mënyrë të plotë.

5.Aparaturë CNC ose teknologji e ngjashme (1 copë)

OE ka dorëzuar një makineri CNC për prerje llamarine, e shoqëruar me dëshmi importi. Përderisa FDT nuk specifikon llojin e materialit për përpunim, kjo pajisje vlerësohet si

përputhëse.

6.Makineri punuese (damper) 3 deri në 5 ton (1 copë)

OE ka paraqitur një damper me kapacitet 2,500 kg, i cili është nën kufirin minimal të përcaktuar prej 3 tonësh. Pajisja nuk përmbush kërkesën për këtë pozitë.

Bazuar në analizën e dokumentacionit të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, rezulton se për disa nga pajisjet e kërkuara në Aneksin 8 të FDT-së mungojnë dëshmitë përputhëse, qoftë për shkak të specifikimeve jo të plota, mungesës së dokumentacionit mbështetës, ose ofrimit të mjeteve të papërshtatshme në raport me kërkesën e përcaktuar. Këto mangësi përbëjnë mospërputhje që nuk mund të trajtohen si devijime të vogla sipas nenit 59.4 të LPP-së.

Gjithashtu, për çmimet e ofruara, edhe pse ankuesi nuk ka ngritur si pretendim çmime jo-normalisht të ulëta, Autoriteti Kontraktues ka pasur përgjegjësi të bëjë vlerësimin e arsyeshmërisë së tyre në përputhje me nenin 41 të Rregullores për Prokurim Publik, veçanërisht në rastet kur çmimet devijojnë dukshëm nga tregu dhe mund të ndikojnë në zbatueshmërinë reale të kontratës. Nga dokumentacioni nuk rezulton që një analizë e tillë të jetë bërë apo të jenë kërkuar sqarime në përputhje me nenin 59.2 të LPP-së.

Në këto rrethana, pretendimi i operatorit ekonomik ankues vlerësohet si pjesërisht i bazuar, për shkak të mospërputhjeve në dokumentacionin teknik të ofertës dhe mungesës së analizës së dokumentuar mbi çmimet e ofertës së OE-së së rekomanduar.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues propozon që lënda të kthehet në rivlerësim, duke u mundësuar Komisionit të Vlerësimit që të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 të LPP-së për elementet e paqarta apo të mangëta, si dhe të kryejë një analizë të arsyeshmërisë së çmimeve, në përputhje me nenin 41 të Rregullores për Prokurim Publik.

Pretendimi Ankimor Nr. 6

Pretendimet ankimore lidhur me eleminimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit janë si në vijim:

1.Lidhur me eliminimin e GOE – Agro Invest 1 SHPK; Rexha; Multi Business Group Shpk – Suharekë, ne pajtohemi me eleminimin nga AK lidhur me mungesën e referencave, dhe kontratave si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit për stafin teknik dhe profesion nuk janë në pajtim me ligjin e punës, andaj me të drejtë është eleminuar.

2.Lidhur me eliminimin e OE – Dardania Shpk – Prishtinë, ne pajtohemi me eleminimin nga AK lidhur me mungesën dokumentacionit përveç formularit të tenderit, çmimeve dhe kërkesat e pranueshmërisë, andaj me të drejtë është eleminuar nga ky AP.

3.Lidhur me eliminimin e GOE – VIA Egnatia; All – ZONE; Infrastruktura Shpk – Prishtinë, ne pajtohemi me eleminimin nga AK lidhur me mungesën e referencave dhe kontratave. Po ashtu i mungon edhe përzierës e betonit që montohet në eskavator; mungon teknikui i makinerisë; mungon specialisti i saldimeve, andaj me të drejtë është eleminuar nga ky AP.

4.Lidhur me eliminimin e GOE – N & B Shpk; BM GROUP SHPK – Skenderaj,ne pajtohemi me eleminimin nga AK lidhur me mungesën e stafit teknik dhe profesional dhe certifikatave me ISO Standardeve të kërkuara në DT dhe NJK, si dhe prezantimin e dokumentacionit edhe kamion

kiper me kran pas i ka skaduar afati i regjistrimit 11 dite para dorëzimit të tenderit, mungon edhe përzierës e betonit që montohet në eskavator, mungon kamioni për bartjen e mbeturinave, nuk ka prezantuar kontrataten ashpte ose ngjashme per kete AP, andaj me të drejtë është eleminuar nga ky AP.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 6

Në vijim të shqyrtimit të pretendimeve për eliminimin e operatorëve ekonomikë nga ky aktivitet prokurimi, eksperti shqyrtues paraqet vlerësimin për secilin rast si më poshtë:

1. Përgjigje ndaj pretendimeve për GOE 'AGRO INVEST 1' SH.P.K.; 'REXHA'; 'MULTI BUSINESS GROUP' SH.P.K.

a) Kontratat e ngjashme me vlerë ≥ 780,000.00 €

Nga dokumentacioni i ofertës rezulton se janë dorëzuar kontrata të shoqëruara me referenca dhe pranim teknik, që përmbajnë elemente të ngjashme me objektin e prokurimit dhe tejkalojnë vlerën minimale të kërkuar. Meqenëse FDT kërkon kontrata "të ngjashme" dhe jo identike, vlerësohet se ky kriter është përmbushur. Rrjedhimisht, eliminimi për këtë arsye është i pabazuar.

b) Dëshmitë për stafin teknik dhe profesional

FDT kërkon që për secilin anëtar të stafit të paraqitet "kontrata e punës e përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, e nënshkruar nga të dy palët". GOE ka dorëzuar marrëveshje bashkëpunimi të firmosura nga të dy palët, të lidhura për projektin konkret dhe që përmbajnë zotim për angazhim gjatë zbatimit të tij. Marrëveshja bashkëpunimi përbën akt juridik të vlefshëm, që plotëson kërkesën për nënshkrim të dyanshëm dhe lidhje me projektin konkret.

Referimi i AK-së në Ligjin e Punës nuk është i aplikueshëm, pasi FDT nuk ka kërkuar përmbajtje të tillë të detajuar. Vendimi për eliminim, mbi këtë bazë, përbën vendosje të kërkesave shtesë dhe është në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së. Prandaj, ky eliminim vlerësohet si i pabazuar.

2. Përgjigje ndaj pretendimeve për OE "DARDANIA" SH.P.K. – Prishtinë

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se ky operator nuk ka plotësuar në mënyrë të rregullt formularin e çmimeve dhe nuk ka dorëzuar sigurimin e tenderit – dokument detyrues për pranueshmëri administrative.

Gjithashtu, mungojnë plotësisht dëshmitë për kapacitetin ekonomik e financiar si dhe për kapacitetin teknik dhe profesional, të kërkuara në FDT.

Në këto kushte, eliminimi i këtij operatori nga procedura është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe konsiderohet i drejtë dhe i bazuar.

3. Përgjigje ndaj pretendimeve për GOE "VIA EGNATIA"; "ALL–ZONE"; "INFRASTRUKTURA" SH.P.K. – Prishtinë

a) Kontratat e ngjashme me vlerë ≥ 780,000.00 €

Nga dokumentacioni i ofertës rezulton se janë dorëzuar kontrata të shoqëruara me referenca dhe dokumente të pranimit teknik, që mbulojnë vlerën dhe natyrën e kërkuar në FDT. Për rrjedhojë, kriteri konsiderohet i përmbushur dhe eliminimi për këtë arsye është i pabazuar.

b) Përzierësi i betonit për eskavator

Operatori ka dorëzuar marrëveshje qiraje për këtë pajisje si dhe faturë përkatëse, ndaj kërkesa vlerësohet si e përmbushur.

c) Tekniku i makinerisë

Për këtë pozitë është caktuar z. B.S., për të cilin janë dorëzuar të gjitha dokumentet mbështetëse sipas kërkesës në DT.

d) Specialisti i saldimeve

Janë paraqitur z. Q.G. dhe z. R.K. si specialistë për këtë pozitë, me dokumentacionin përkatës të plotë dhe të përputhshëm me kërkesat.

Në këto rrethana, eliminimi i këtij operatori konsiderohet si i pabazuar.

4. Përgjigje ndaj pretendimeve për GOE “N & B” SH.P.K.; “BM GROUP” SH.P.K. – Skenderaj

a) Salduesi me certifikatë ISO EN ISO 9606

Operatori ka dorëzuar CV, certifikatë ISO dhe kontratë pune për salduesin, por CV-ja nuk ishte e nënshkruar. Kjo përbën një mangësi formale, e cila nuk cenon përmbajtjen e ofertës dhe mund të korrigjohej përmes një sqarimi sipas nenit 59.2 të LPP-së. Në mungesë të një kërkese për sqarim, eliminimi vlerësohet si i pabazuar.

b) Kamionët kipper me kran

Operatori ka dorëzuar dy kamionë të tillë në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Prandaj, pretendimi për mospërputhje është i pabazuar.

c) Përzierësi i betonit për eskavator

Në ofertë është dorëzuar marrëveshje për shfrytëzim të kësaj pajisjeje, e shoqëruar me dëshmi doganore. Kriteri vlerësohet si i përmbushur.

d) Kamioni për bartjen e mbeturinave

OE ka dorëzuar librezë për një mjet tip kamionetë (dubelkabinë), e shoqëruar me fotografi, por pa dokumentacion që dëshmon funksionalitetin për bartjen e mbeturinave (si kontenier, mekanizëm ngritës, etj). Prandaj, ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur.

e) Kontratat e ngjashme me vlerë ≥ 780,000.00 €

Janë dorëzuar kontrata të shoqëruara me referenca dhe pranim teknik që përmbushin kriterin për kontrata të ngjashme dhe tejkalojnë vlerën e kërkuar. Prandaj, eliminimi për këtë arsye është i pabazuar.

Pretendimi Ankimor Nr. 7

Përfundim i ankesës (kompania “Muhamet Muçiqi”):

Në përfundim të ankesës, Operatori Ekonomik “Muhamet Muçiqi” pretendon se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me parimet e LPP-së, ndonëse sipas tyre, ata kanë përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit, përfshirë kërkesat teknike dhe profesionale sipas nenit 9.1 dhe 9.2 të FDT-së.

Ankuesi thekson se ka ofertuar me çmim më të ulët dhe më të përgjegjshëm sesa OE i rekomanduar për kontratë, duke vlerësuar se oferta fituese është rreth 194% më e shtrenjtë, çka përbën shkelje të parimit “vlera për para” dhe ka sjellë dëmtim të buxhetit të komunës.

Gjithashtu, ankuesi pretendon se AK ka zbatuar standard të dyfishtë duke i kërkuar sqarime OE-së së rekomanduar për mungesa të rëndësishme, ndërsa vetë është eliminuar për një mungesë formale (nënshkrimi në CV). Ai bashkëngjit edhe deklaratën e teknikut Agron Bytyqi për të provuar se mungesa e nënshkrimit nuk ka qenë e qëllimshme dhe nuk e cenon vlefshmërinë e dokumentit, duke theksuar se kjo nuk përbën arsye logjike për eliminim dhe se komisioni i vlerësimit ka dështuar të veprojë sipas nenit 52.7 të LPP-së.

Ankuesi vë në dukje se AK nuk ka shqyrtuar fare kërkesën për rishqyrtim dhe nuk ka dhënë përgjigje, duke mos vepruar në pajtim me nenin 108/A të LPP-së dhe duke shkelur nenet 7, 59 dhe 60 për trajtimin e barabartë, transparencën dhe vlerësimin e çmimit më të ulët të përgjegjshëm. Sipas tij, vendimi është i paarsyetuar dhe i pambështetur në të dhëna të tregut. Në mbështetje të pretendimeve, ankuesi referon edhe vendime të mëhershme të OSHP-së. Po ashtu, theksohet shkelja e nenit 1 të LPP-së për menaxhimin efikas dhe në interes të publikut.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 7

Eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë të veçantë dhe të detajuar çdo pretendim të ngritur nga operatori ekonomik “Muhamet Muçiqi”, duke u bazuar në dokumentacionin e ofertës, kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik.

Në përgjithësi, Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të veprojë në përputhje me nenin 7 të LPP-së (trajtim i barabartë), nenin 59 (vlerësimi i ofertave sipas kritereve të përcaktuara) dhe nenin 60 (përzgjedhja e ofertës më të ulët të përgjegjshme), duke u bazuar në kriteret që vetë i ka vendosur në Dosjen e Tenderit. Çdo vlerësim që devijon nga këto parime mund të cenojë konkurrencën e ndershme dhe integritetin e procesit prokuror.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për mospërgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim, vërehet se Autoriteti Kontraktues ka dhënë përgjigje, por në mënyrë të përgjithshme dhe pa hyrë në analizë të detajuar për secilin pretendim të ngritur në kërkesë. Ky veprim nuk është në përputhje të plotë me nenin 108/A të LPP-së, i cili në paragrafin 9 përcakton qartë se:

“Refuzimi do të arsyetohet dhe do t’i komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.”

Ky nen i ngarkon Autoritetet Kontraktuese me detyrimin për të dhënë përgjigje të arsyetuar dhe të plotë, për të garantuar transparencën dhe për të mundësuar një proces efikas ankimi.

Për më tepër, sa i përket pretendimit të ankuesit mbi standarde të dyfishta, eksperti vëren se një vlerësim korrekt kërkon trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve, përfshirë dhënien e mundësisë për sqarim në rast të mangësive të natyrës formale. Nëse një operator ka përfituar nga kjo mundësi, ndërsa tjetrit i është refuzuar, kjo duhet të justifikohet në mënyrë objektive dhe të dokumentuar.

Për secilin prej pretendimeve specifike të ngritura nga "Muhamet Muçiqi", eksperti shqyrtues ka dhënë vlerësime të ndara në pjesët përkatëse të raportit. Në përfundim, vlerësimi për bazueshmërinë e ankesës është bërë mbi analiza të hollësishme të ofertës, kërkesave të FDT-së dhe zbatimit të dispozitave ligjore përkatëse.

PËRFUNDIM

Pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura nga operatori ekonomik ankues dhe analizës së dokumentacionit të ofertave dhe të tenderit, eksperti shqyrtues vlerëson se disa nga çështjet e ngritura meritojnë trajtim të kujdesshëm, veçanërisht në raport me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të kritereve të kualifikimit të përcaktuara në Formularin e të Dhënave të Tenderit (FDT).

Në disa raste është konstatuar se eliminimi i ofertave është bërë mbi baza formale, pa shfrytëzuar mundësinë ligjore për kërkesë për sqarime sipas nenit 59.2 të LPP-së, edhe pse mangësitë nuk e cenonin përmbajtjen thelbësore të ofertës. Po ashtu, është vërejtur se disa operatorë janë eliminuar për devijime të vogla, ndërkohë që për ofertues të tjerë janë toleruar mospërputhje më të mëdha, duke ngritur shqetësime për mungesë trajtimi të barabartë në kuptim të nenit 7 të LPP-së.

Në këtë kontekst, eksperti shqyrtues propozon që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa lënda të kthehet në rivlerësim, në pajtim me nenin 59 të LPP-së dhe nenet 40.12 e 40.13 të Rregullores për Prokurim Publik. Gjatë rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues duhet të sigurojë trajtim të barabartë, objektiv dhe jo-diskriminues të të gjithë operatorëve ekonomikë, duke u udhëhequr nga parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe efikasitetit, siç janë të përcaktuara në nenet 1, 6 dhe 7 të LPP-së.

***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –***

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit: 616-25-1830-5-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "VIA EGNATIA" SH.P.K., dhe se argumentimi në raportin e ekspertes është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "VIA EGNATIA" SH.P.K., janë të bazuara. të anulohet njoftimi për dhënie dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit: 616-25-1830-5-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AGRO INVEST 1" SH.P.K dhe se argumentimi në raportin e ekspertes është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorve ekonomik ankues "AGRO INVEST 1" SH.P.K: N & B" SH.P.K: Muhamet Muçiqi janë pjesërisht të bazuara .

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesat e operatorve ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesat e operatorve i sheh si te bazuara dhe pjeserisht te bazuara, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit: 616-25-1830-5-1-1, të anulohet B58Njoftimi mbi vendimin e AK-së, ndërkaq lënda kthehet në rivlerësim ku AK-ja obligohet të veproj në harmoni me rekomandimet e ekspertit shqyrtues, si dhe dispozitat ligjore të LPP-së.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahimi**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- OE - **VIA EGNATIA SH.P.K., " N & B " SH.P.K., " AGRO INVEST 1 " SH.P.K., Muhamet Muçiqi**
- Arkivës së OSHP-së: